

CONCORDANCE E TESTAMENTIT TË RI

A

Aaron.

-Hebrenjve 5,4. Edhe asnjë nuk e merr këtë nder prej vetes së tij, po ai që thirret nga Perëndia, si Aroni.

Abel.

-Matheu 23, 35. Që të vijë mbi ju çdo gjak i drejtë që është derdhur mbi dhe, që nga gjaku i Abelit të drejtë e deri në gjakun e Zaharisë.

-Lluka 11, 51. Që nga gjaku i Abelit deri në gjakun e Zaharisë, i cili u vra në mes të therores e të tempullit.

-Hebrenjve 11, 4. Me anë të besimit Abeli i ofroi Perëndisë therore më të mirë se Kaini.

-Hebrenjve 12, 24. Edhe te ndërmjetësi i dhiatës së re Jisu, dhe në gjakun e spërkatjes, që flet më mirë se ai i Abelit.

Abraham.

-Matheu 8, 11. Edhe po ju them juve, se shumë do të vijnë nga lindja e nga perëndimi, dhe do të rrinë bashkë me Abrahamin e me Isakun e me Jakovin në mbretërinë e qiejve.

-Matheu 22, 32. “Unë jam Perëndia i Abrahamit dhe Perëndia i Isakut dhe Perëndia i Jakovit”?

-Joani 8, 39. Iu përgjigjën e i thanë: Ati ynë është Abrahami. Jisui u thotë atyre: Po të ishit bij të Abrahamit, punët e Abrahamit do të bënit.

-Romakëve 4, 3. Sepse ç’thotë shkrimi? “Edhe i besoi Abrahami Perëndisë, dhe iu llogarit atij për drejtësi.”

-Hebrenjve 6, 13. Sepse Perëndia, kur i premtoi Abrahamit pasi s'kishte asnjë më të madh, mbi të cilin të betohej, u betua mbi veten e tij.

-Galatasve 3, 29. Edhe nëse ju jeni të Krishtit, sigurisht jeni farë e Abrahamit dhe sipas premtimit trashëgimtarë.

-Hebrenjve 11, 8. Me anë të besimit u bind Abrahami, kur u thirr të dalë në vendin që do të merrte për trashëgim, dhe doli pa ditur se ku shkon.

-Jakovit 2, 21. Abrahami, ati ynë, a nuk doli i drejtë nga veprat, kur pruri Isakun, të birin e tij, mbi theroren?

Adam.

-Lluka 3, 38. I Enosit, i Setit, i Adamit, i Perëndisë.

-1 Korintasve 15, 22. Sepse sikurse të gjithë vdesin në Adamin, kështu edhe të gjithë do të marrin jetë në Krishtin.

-Romakëve 5, 14. Por vdekja mbretëroi që prej Adamit deri te Moisiu edhe mbi ata që nuk mëkatuan sipas shembullit të mëkatit të Adamit, i cili ishte model i atij që do të vinte.

-1 Timotheut 2, 14. Edhe Adami nuk u gënjye, po gruaja u gënjye e doli jashtë udhës.

Adhuroj.

-Matheu 4, 10. Atëherë Jisui i thotë atij: Ik prej meje, Satana. Sepse është shkruar: “Zotit Perëndisë tënd do t'i falesh, dhe vetëm atij do t'i lutesh”.

-Lluka 4, 8. Po Jisui u përgjigj e i tha: Shporru prapa meje, Satana, sepse është shkruar: “Zotit Perëndisë tënd, do t'i falesh, dhe vetëm atij do t'i lutesh”.

-Joani 4, 20. Etërit tanë në këtë mal u falën, e ju thoni se në Jerusalem është vendi, ku duhet të falemi.

-Joani 4, 22. Ju i falemi atij që nuk dini, ne i falemi atij që

dimë; sepse shpëtimi është nga Judenjtë.

-Joani 12, 20. Edhe ishin ca Grekë në mes tyre që ishin ngjitur për t'u falur në të kremten.

-Veprat e Apostujve 8, 27. Ky kishte ardhur që të falet në Jerusalem.

-Veprat e Apostujve 17, 23. Atë pra që nuk e njihni dhe e adhuroni.

-Veprat e Apostujve 19, 27. Të cilën gjithë Azia dhe bota e nderon.

-Hebrenjve 11, 21. Dhe u fal duke u mbështetur mbi majën e shkopit të tij.

-Zbulesa 7, 11. Ranë përmbys përpara fronit, e iu falën Perëndisë.

-Zbulesa 9, 20. Që të mos u falen djajve dhe idhujve të artë e të argjendte e të bakërt e të gurtë e të drunjte.

-Zbulesa 11, 1. Ngrihu dhe mat tempullin e Perëndisë dhe altarin dhe ata që falen në të.

-Zbulesa 11, 16. Edhe të njëzet e katër pleqtë që rrinin përpara Perëndisë mbi fronet e tyre ranë me fytyrë përdhe, dhe iu falën Perëndisë.

-Zbulesa 13, 4. Edhe iu falën dragoit që i dha pushtet bishës, dhe iu falën bishës.

-Zbulesa 14, 9. Kush t'i falet bishës dhe ikonës së saj, dhe të marrë gërvishtje mbi ballin e tij ose mbi dorën e tij.

-Zbulesa 19, 4. Iu falën Perëndisë që rrinte mbi fron, duke thënë: Amin. Aliluia.

-Zbulesa 20, 4. Të cilët nuk iu falën bishës, as ikonës së saj.

Afërm (i, e).

-Lluka 10, 27. Të afërmin tënd posi veten tënde.

-Lluka 10, 36. Cili nga këta të tre të duket se u bë i afërmi i atij që ra në duart e kusarëve?

-Romakëve 13, 10. Dashuria nuk i bën keq të afërmit; dashuria pra është përmbushja e ligjit.

-Efesianëve 4, 25. Prandaj, duke hedhur tej gënjeshtren, “flitni të vërtetën secili me të afërmin e tij”, sepse jemi pjesë të njëri-tjetrit.

Agab

-Veprat e Apostujve 11, 28. Edhe u ngrit një nga ata që quhej Agab.

-Veprat e Apostujve 21, 10. Edhe ndërsa ne ishim duke qëndruar atje mjaft ditë, zbriti nga Judea një profet që quhej Agab.

Agjëroj.

-Matheu 6, 16. Edhe kur të agjëroni, mos u bëni të vrenjtur si hipokritët; sepse ata prishin fytyrat e tyre, që të duken ndër njerëzit se agjërojnë.

-Marku 2, 18. Edhe nxënësit e Joanit dhe ata të Farisenjve

agjëronin; dhe vijnë, e i thonë: Pse nxënësit e Joanit e ata të Farisenjve agjërojnë dhe nxënësit e tu nuk agjërojnë?

-Lluka 5, 33. Edhe ata i thanë: Pse nxënësit e Joanit agjërojnë dendur dhe bëjnë lutje, gjithashtu edhe ata të Farisenjve, por të tutë hanë e pinë?

-Lluka 5, 34. Edhe ai u tha atyre: Mos mund t’i bëni dasmorët të agjërojnë deri sa të jetë dhëndri bashkë me ta?

Akeldama.

-Veprat e Apostujve 1, 19. Edhe kjo u bë e ditur tek të gjithë ata që rrinin në Jerusalem, kaq sa ajo arë u quajt në gjuhën e tyre Akeldama, që do me thënë Arë gjaku.

Aleksandër.

-Veprat e Apostujve 19, 33. Edhe prej turmës nxorën përpara Aleksandrin që të fliste, sepse Judenjët e kishin

vënë përpara, dhe Aleksandri tundi dorën e deshi t'i flasë turmës.

-1 Timotheut 1, 20. Prej këtyre është Imeneu dhe Aleksandri, të cilët i kam dhënë në dorë të satanait, që të mësohen të mos blasfemojnë.

-2 Timotheut 4, 14. Aleksandër bakërpunuesi shumë të liga më bëri; Zoti ia shpagoftë sipas punëve të tij.

Altar.

-Veprat e Apostujve 17, 23. Sepse, duke shkuar e duke vënë re vendet e adhurimit tuaj, gjeta edhe një altar, mbi të cilin është shkruar: Perëndisë së Panjohur.

-Hebrenjve 7, 13. Sepse ai, për të cilin thuhet këto, ishte prej tjetër fare, prej së cilës asnjë s'i qe afruar altarit.

-Hebrenjve 13, 10. Kemi një therore, prej së cilës s'kanë pushtet të hanë ata që adhurojnë në tendë.

-Zbulesa 6, 9. Edhe kur hapi vulën e pestë, pashë përposh altarit shpirtrat e atyre që janë therur për fjalën e Perëndisë, dhe për dëshminë që kishin.

-Matheu 23, 18. Edhe: Kush të betohet për altarin, nuk është gjë; po kush të bëjë be për dhuratën që është mbi të, ka detyrim.

Anania.

-Veprat e Apostujve 5, 1. Po një burrë që e kishte emrin Anania, bashkë me gruan e tij, Sappirën, shiti një prone.

-Veprat e Apostujve 22, 12. Edhe njëfarë Ananie, njeri besimtar pas ligjit e me dëshmi të mirë prej gjithë Judenjve që rrinin atje.

-Veprat e Apostujve 23, 2. Edhe kryepriifti Anania i urdhëroi ata që rrinin pranë atij t'i bien gojës.

Andrea.

-Matheu 4, 18. Edhe tek ecte Jisui pranë detit të Galilesë, pa dy vëllezër, Simonin, që thirrej edhe Pjetër, dhe Andrean, vëllanë e tij, duke hedhur rrjetën në det; sepse ishin peshkatarë.

-Joani 12, 22. Filipi vjen e i thotë Andreas; dhe përsëri Andrea e Filipi i thonë Jisuit.

-Veprat e Apostujve 1, 13. Edhe kur hynë, u ngjitën në dhomën e sipërme, ku kishin të ndenjurit Pjetri dhe Jakovi dhe Joani e Andrea, Filipi dhe Thomai, Vartholomeu dhe Matheu, Jakovi i biri i Alfeut dhe Simon Zeloti, dhe Juda, i vëllai i Jakovit.

Ankth.

-Matheu 6, 25. Prandaj po ju them juve: Mos u mendoni për jetën tuaj, ç'të hani a ç'të pini; as për trupin tuaj ç'të vishni.

-Matheu 6, 34. Mos u mendoni, pra, për të nesërmen,

sepse e nesërmja do të ketë mendim për punët e saj; mjaft është në çdo ditë e keqja e saj.

-Matheu 10, 19. Po kur t'ju dorëzojnë, mos kini kujdes se si a se ç'do të flisni.

-Matheu 13, 22. Edhe ç'u mboll ndër drizat, ky është ai që dëgjon fjalën; por kujdesi i kësaj bote, dhe gënjimi i pasurisë mbyt fjalën, dhe bëhet i pafrytshëm.

-Marku 4, 19. Por kujdesjet e kësaj jete dhe gënjimi i pasurisë, dhe dëshirimet për të tjera gjëra, hyjnë e mbysin fjalën, dhe kjo bëhet e pafrytshme.

-Lluka 2, 48. Edhe kur e panë atë, u habitën; dhe e ëma i tha: O bir, ç'na bëre kështu? Ja, po të kërkojmë me pikëllim.

-Lluka 10, 41. Edhe Jisui u përgjigj e i tha asaj: Marta, Marta, përpiqesh e mundohesh për shumë punë.

-Lluka 21, 25. Edhe do të ketë shenja në diell e në hënë e në yjet; dhe mbi tokë shtrëngim kombesh që nuk dinë ç'do të bëhen; dhe do të buçasë deti dhe valët.

-1 Korintasve 7, 32. Edhe dua të jeni pa kujdese; i pamartuari ka kujdes për punët e Zotit, si t'i pëlqejë Zotit.

-2 Korintasve 2, 4. Sepse me shumë hidhërim e dhimbje zemre ju shkrova me shumë lot, jo që të hidhërohemi, por që të njihni dashurinë që kam me tepricë për ju.

Apostull.

-Matheu 10, 2. Edhe emrat e të dymbëdhjetë Apostujve janë këto.

-Marku 3, 14. Edhe zgjodhi dymbëdhjetë veta, që të jenë bashkë me të dhe që t'i dërgojë të predikojnë.

-1 Korintasve 4, 9. Sepse më duket se Perëndia ne apostujt

na tregoi për më të fundit e njerëzve.

-2 Korintasve 11, 13. Sepse njerëz të tillë janë apostuj të rremë, punëtorë mashtrues, të shndërruar në formë në apostuj të Krishtit.

-Galatasve 1, 1. Pavli, apostull jo prej njerëzish, as me anë njeriu, po me anë të Jisu Krishtit, dhe të Perëndisë Atë që e ngjalli atë prej së vdekurish.

-Hebrenjve 3, 1. Prandaj, vëllezër shenjtorë, pjesëtarë të thirrjes qiellore, vështroni apostullin dhe kryepriftin e rrëfimit tonë, Jisu Krishtin.

-Zbulesa 21, 14. Edhe muri i qytetit kishte dymbëdhjetë themele, edhe në to ishin emrat e të dymbëdhjetë apostujve të Qengjit.

Areopag.

-Veprat e Apostujve 17, 19. Edhe ata e kapën dhe e çuan në Areopag, duke thënë: A

mund të marrim vesh, ç'është ky mësim i ri që flitet prej teje?

-Veprat e Apostujve 17, 22. Atëherë Pavli qëndroi në mes të Areopagut, e tha: O burra Athinas, shikoj se mbi të gjitha jeni tepër besimtarë.

Argjend.

-Matheu 26, 16. Edhe ata i dhanë tridhjetë monedha argjendi.

-Veprat e Apostujve 3, 6. Atëherë Pjetri tha: Argjend dhe ar nuk kam; po atë që kam, këtë ta jap. Në emrin e Jisu Krisht Nazaretasit, ngrihu dhe ec.

Arimatea.

-Matheu 27, 57. Edhe si u ngrys, erdhi një njeri i pasur nga Arimatea me emrin Josif, që edhe ai vetë kishte qenë nxënës tek Jisui.

-Lluka 23, 51. Nga Arimatea, qytet i Judenjve, i cili edhe vetë priste mbretërinë e Perëndisë.

-Joani 19, 38. Edhe pas këtyre Josifi që ishte nga Arimatea, i cili ishte nxënës i Jisuit.

Armik.

-Matheu 10, 36. Edhe armiqtë e njeriut do të jenë pjesëtarët e shtëpisë së tij.

-Matheu 13, 39. Edhe armiku që mbollti atë, është djalli; dhe korrja është mbarimi i jetës; dhe korrësit janë engjëjt.

-Romakëve 11, 28. Sipas ungjillit janë armiq për ju, por sipas zgjedhjes janë të dashur për shkak të etërve.

-Romakëve 12, 20. Në i ardhhtë uri pra armikut tënd, jepi të hajë; në i ardhhtë etje, jepi të pijë.

-1 Korintasve 15, 25. Sepse duhet të mbretërojë ai, deri sa të vërë gjithë armiqtë nën këmbët e tij.

-1 Korintasve 15, 26. Armiku i fundit që do të asgjësohet është vdekja.

Atë.

-Matheu 6, 9. Po ju faluni kështu: Ati ynë që je në qiejt, u shenjtëroftë emri yt.

-Lluka 2, 49. A nuk e dinit se unë duhet të jem në punët e Atit tim?

-Joani 8, 44. Ju jeni prej djallit, atit tuaj, dhe doni të bëni dëshirat e atit tuaj.

-Joani 14, 28. Po shkoj tek Ati; sepse Ati im është më i madh se unë.

-Jakovi 1, 17. Çdo dhënie e mirë, dhe çdo dhuratë e përsosur, është nga lart, dhe zbret nga Ati i dritave,

-Zbulesa 14, 1. Që kishin emrin e Atit të tij të shkruar mbi ballet e tyre.

August.

-Veprat e Apostujve 27, 1. Tek një kryeqindësh që quhej Jul, prej trupës së Augustit.

B

Babiloni.

-Zbulesa 17, 5. Edhe mbi ballin e saj ishte shkruar një emër: Mister, Babilona e madhe, nëna e të përdalave dhe e ndyrësive të dheut.

-Zbulesa 18, 2. Ra, ra Babilona e madhe, dhe u bë banesë djajsh dhe strofkë e çdo fryme të ndyrë.

Banoj.

-Romakëve 7, 20. Edhe nëse bëj unë atë që nuk dua, më nuk e bëj unë atë, po mëkati që rri tek unë.

-1 Korintasve 3, 16. Nuk e dini se jeni tempull Perëndie, dhe Shpirti i Shenjtë rri tek ju?

-Efesianëve 2, 22. Në të cilin edhe ju jeni ndërtuar që të bëhet banesë e Perëndisë me anë të Shpirtit.

Baraba.

-Joani 18, 40. Atëherë të gjithë bërtitën përsëri, duke thënë: Mos lësho këtë, po Barabain. Dhe Barabai ishte kusar.

Bari.

-Matheu 26, 31. Do të godas bariun dhe dhentë e tufës do të shpërndahen.

-Lluka 2, 8. Edhe në atë vend nëpër arat ishin disa barinj, duke ruajtur me radhë natën tufën e tyre.

-Joani 10, 11. Unë jam bariu i mirë; bariu i mirë vë jetën e tij për dhentë.

-Joani 10, 16. Dhe do të bëhet një tufë, një bari.

-Efesianëve 4, 11. Edhe ai dha që disa të jenë apostuj, e disa profetë, e disa ungjillorë, dhe disa barinj e mësues.

-Hebrenjve 13, 20. Edhe Perëndia i paqes, i cili ngriti prej së vdekurish bariun e madh të dhenve.

Barnaba.

-Veprat e Apostujve 15, 2. Po pasi Pavli dhe Barnaba u qëndruan kundër dhe u hëngrën me fjalë jo pak me ata, vendosën që Pavli e Barnaba dhe disa të tjerë.

-1 Korintasve 9, 6. Apo vetëm unë dhe Barnaba nuk kemi pushtet të mos punojmë?

-Galatasve 2, 1. Pastaj, pas katërmëdhjetë vjetësh, përsëri u ngjita në Jerusalem bashkë me Barnabën, si mora me vete edhe Titon.

Bartolomeu.

-Matheu 10, 3. Filipi dhe Bartolomeu; Thomai dhe Mathe tagrambledhësi.

-Veprat e Apostujve 1, 13. Pjetri dhe Jakovi dhe Joani e Andrea, Filipi dhe Thomai, Bartolomeu dhe Matheu.

Bekoj.

-Romakëve 12, 14. Bekoni ata që ju përndjekin; bekoni e mos mallkoni.

-1 Korintasve 10, 16. Kupa e bekimit që bekojmë, a nuk është pjesëmarrje në gjakun e Krishtit?

Besëlidhje.

-Matheu 26, 28. Sepse ky është gjaku im i dhiatës së re, që derdhet për shumë veta për ndjesën e mëkateve.

-Lluka 22, 29. Prandaj edhe unë bëj gati për ju një mbretëri, sikurse im Atë për mua.

-1 Korintasve 11, 25. Kjo kupë është dhiata e re në gjakun tim.

-2 Korintasve 3, 6. I cili edhe na bëri të zotët të jemi shërbëtorë të dhiatës së re.

-2 Korintasve 3, 14. Sepse deri në ditën e sotme po ajo mbulesë në leximin e dhiatës së vjetër.

-Galatasve 4, 24. Këto janë alegorike; sepse këtu janë të dy dhiatat, njëra nga mali Sinai.

-Hebrenjve 8, 6. Po tani Krishti mori një shërbesë aq të shquar, sa është edhe ndërmjetës i një dhiate më të mirë.

-Hebrenjve 9, 17. Sepse dhiata ka fuqi mbi ata që kanë vdekur; sepse kurrë s'ka fuqi deri sa rron ai që bëri dhiatën.

-Hebrenjve 12, 24. Te ndërmjetësi i dhiatës së re Jisu.

Besim.

-Lluka 18, 8. Po kur të vijë i Biri i njeriut, vallë, a do ta gjejë besimin mbi dhe?

-Joani 3, 16. Që të mos humbasë kushdo që t'i besojë atij, po të ketë jetë të përjetshme.

-Romakëve 4, 13. Po me anë të drejtësisë që është prej besimit.

-Romakëve 10, 9. Në besofsh në zemrën tënde se Perëndia e ngjalli atë prej së vdekurish, do të shpëtosh.

-Romakëve 14, 23. Sepse nuk e bën nga besimi; dhe çdo gjë që nuk bëhet nga besimi, është mëkat.

-Galatasve 3, 8. Perëndia i nxjerr kombet të drejtë prej besimit.

-Galatasve 3, 11. Sepse i drejti do të rrojë prej besimit.

-Galatasve 6, 10. Veçanërisht atyre që janë në një besim me ne.

-Efesianëve 4, 5. Një Zot, një besim, një pagëzim.

-1 Timotheut 6, 12. Lufto luftën e mirë të besimit, rrok jetën e përjetshme.

-2 Timotheut 4, 7. Luftën e mirë luftova, udhën e mbarova, besimin e ruajta.

-Hebrenjve 11, 1. Edhe besimi është ekzistencë e gjërave që shpresohen.

-Hebrenjve 11, 17. Me anë të besimit Abrahami, kur provohej, pruri Isakun për theror.

-Hebrenjve 12, 2. Duke shikuar tek Jisui që është kryet dhe fundi i besimit.

-Jakovit 2, 26. Kështu edhe besimi pa veprat është i vdekur.

Betani.

-Matheu 21, 17. Edhe si i la ata, doli jashtë qytetit në Betani, dhe e shkoi natën atje.

-Matheu 26, 6. Edhe kur ishte Jisui në Betani, në shtëpinë e Simon lebrozit.

-Joani 1, 28. Këto u bënë në Betani përtej Jordanit, atje ku ishte Joani duke pagëzuar.

-Joani 11, 1. Edhe ishte një njeri i sëmurë, që quhej Llazar, nga Betania.

Betlehem.

-Matheu 2, 1. Edhe si lindi Jisui në Betlehem të Judesë, në ditët e mbretit Irod.

-Matheu 2, 5. Edhe ata i thanë atij: Në Betlehem të Judesë.

-Lluka 2, 4. Në qytetin e Davidit, që quhet Betlehem.

Betohem.

-Matheu 5, 34. Por unë po ju them juve, të mos bëni be fare, as për qiellin, sepse është froni i Perëndisë.

-Veprat e Apostujve 2, 30. Perëndia me betim i premtoi se nga pema e mesit të tij.

-Hebrenjve 6, 13. Sepse Perëndia, kur i premtoi Abrahamit pasi s'kishte asnjë më të madh, mbi të cilin të betohej, u betua mbi veten e tij.

Betsaida.

-Matheu 11, 21. Mjerë ti, Horazin! Mjerë ti, Betsaida!

-Lluka 9, 10. Në një vend të shkretëtë të një qyteti që quhej Betsaida.

-Joani 1, 45. Edhe Filipi ishte nga Betsaida, nga qyteti i Andreas dhe i Pjetrit.

Bindem.

-Lluka 16, 31. Në qoftë se nuk dëgjojnë Moisiun dhe profetët, as në u ngjalltë ndonjë nga të vdekurit, s'kanë për t'u bindur.

-Romakëve 6, 16. Nuk e dini, se në atë që tregoni veten tuaj shërbëtorë që t'i bindeni, jeni shërbëtorë të atij që i bindeni, ose të mëkatit për vdekje, ose të bindjes për drejtësi?

-Efesianëve 6, 1. Ju bij, bindjuni prindërve tuaj në Zotin, sepse kjo është e drejtë.

-Filipianëve 2, 8. E përuli veten e tij, duke u bërë i bindur deri në vdekje, dhe vdekje kryqi.

-2 Selanikasve 1, 8. Atyre që nuk i binden ungjillit të Zotit tonë Jisu Krisht.

-Hebrenjve 5, 8. Ndonëse ishte bir, mësoi nga ato që pësoi që të jetë i bindur.

-Hebrenjve 11, 8. Me anë të besimit u bind Abrahami.

Bir.

-Matheu 3, 17. Ky është biri im i dashur, që e kam pëlqyer.

-Lluka 16, 8. Të bijtë e kësaj jete janë më të mençur në brezin e tyre, sesa të bijtë e dritës.

-Joani 3, 16. Sepse Perëndia aq e deshi botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin.

-Joani 17,1. Atë, erdhi ora, lavdëro Birin tënd, që të të lavdërojë edhe yt Bir.

-Romakëve 8, 14. Sepse sa udhëhiqen prej Shpirtit të Perëndisë, këta janë bij të Perëndisë.

-2 Korintasve 6, 18. Dhe “do të jem Ati juaj, dhe do të jeni bijtë e mi dhe bijat e mia.

-Hebrenjve 12, 7. Perëndia sillet me ju si me bij; sepse cili është ai bir që s’e mundon i ati?

-Hebrenjve 11, 24. Me anë të besimit Moisiu, si u bë i madh, mohoi të quhej i biri i së bijës së Faraonit.

Biri i njeriut.

-Matheu 8, 20. Po i biri i njeriut s’ka ku të mbështesë kryet.

-Matheu 10, 23. Nuk do t’i mbaroni së bredhuri qytetet e Izraelit, deri sa të vijë i biri i njeriut.

-Matheu 12, 40. Kështu do të jetë edhe i Biri i njeriut në zemër të dheut tri ditë e tri net.

-Matheu 17, 22. Biri i njeriut do t’u dorëzohet njerëzve.

-Matheu 24, 30. Edhe atëherë do të duket shenja e Birit të njeriut në qiell.

-Lluka 17, 26. Kështu do të jetë në ditët e të Birit të njeriut.

-Lluka 18, 8. Po kur të vijë i Biri i njeriut, vallë, a do ta gjejë besimin mbi dhe?

-Joani 3, 13. Biri i njeriut, që është në qiell.

Blasfemi.

-Matheu 12, 31. Çdo faj e çdo sharje do t'u ndjehet njerëzve; po sharja kundër Shpirtit të Shenjtë nuk do t'u ndjehet njerëzve.

-Matheu 26, 65. Atëherë kryepriifti çori rrobat e tij, duke thënë se: Blasfemoi; ç'nevojë kemi më për dëshmitarë? Ja tani tek e dëgjuat blasfeminë e tij.

-Marku 3, 29. Por ai që të blasfemojë kundër Shpirtit të Shenjtë.

-Marku 14, 64. E dëgjuat blasfeminë; ç'ju duket juve?

-Joani 10, 33. Nuk të qëllojmë me gurë për punë të mirë, po

për blasfemi, dhe sepse ti, ndonëse je njeri, e bën veten tënde Perëndi.

-Veprat e Apostujve 6, 11. Atëherë vunë e gënjyen disa njerëz të thonë se e dëgjuam duke folur fjalë sharjeje kundër Moisiut dhe Perëndisë.

-Zbulesa 2, 9. I di punët e tua dhe shtrëngimin dhe varfërinë, - por je i pasur, - dhe blasfeminë e atyre që thonë për veten e tyre se janë Judenj.

Blatim.

-2 Timotheut 4, 6. Sepse unë tani jam duke derdhur gjakun, dhe koha e ikjes sime arriti.

-Hebrenjve 10, 14. Sepse me një dhuratë bëri të përsosur përgjithnjë ata që shenjtërohen.

-Efesianëve 5, 2. Edhe ecni me dashuri, sikurse edhe Krishti na deshi, edhe dha veten e tij për ne dhuratë e theror tek Perëndia, për aromë erëmirë.

Bollëk.

-Lluka 12, 15. Vështroni e ruhuni nga lakmia. Sepse në pastë tepër ndonjë, jeta e tij nuk është bërë prej pasurisë së tij.

-Joani 10, 10. Vjedhësi nuk vjen, veçse për të vjedhur e për të therur e për të prishur; unë erdha që të kenë jetë, dhe ta kenë me të tepërt.

-Romakëve 5, 15. Hiri i Perëndisë dhe dhurata me anë të hirit të një njeriu, të Jisu Krishtit, teproni në të shumtët.

-Romakëve 6, 1. Të qëndrojmë në mëkat, që të teprojë hiri?

-2 Korintasve 1, 5. Sepse, siç teprojnë tek ne pësimet e Jisu Krishtit, kështu me anë të Jisu Krishtit tepron edhe ngushëllimi ynë.

-2 Korintasve 4, 15. Sepse të gjitha janë për ju, që hiri, duke tepruar për falënderimin e më

të shumtëve, të teprojë në lavdinë e Perëndisë.

-2 Korintasve 8, 7. Po siç teproni në çdo gjë, në besim dhe në fjalë dhe në dituri dhe në çdo kujdes, e në dashurinë tuaj për ne, kështu të teproni edhe në këtë hir.

-2 Korintasve 9, 8. Edhe Perëndia është i fortë të shtojë me të tepërt çdo hir tek ju, që duke pasur gjithnjë në çdo gjë gjithë sa duhen, t'ju teprojnë për çdo punë të mire.

-2 Korintasve 9, 10. Dhëntë e shumoftë farën tuaj, dhe rritë frytet e drejtësisë suaj.

Borxh.

-Matheu 18, 27. Edhe të zotit, si iu dhimbs për atë shërbëtor, e lëshoi, dhe ia la detyrimin.

-Lluka 7, 41. Një huadhënës kishte dy debitorë; njëri i kishte detyrim pesëqind dinarë, dhe tjetri pesëdhjetë.

-Romakëve 1, 14. U jam i detyruar Grekëve e barbarëve, të diturve e të paditurve. nga bota, por unë ju zgjodha ju nga bota, prandaj ju ka mëri bota.

-Romakëve 15, 27. Me të vërtetë u pëlqeu, dhe u janë të detyruar atyre. -Joani 17, 16. Nuk janë nga bota, siç nuk jam unë nga bota.

Botë.

-Matheu 24, 21. Sepse atëherë do të jetë shtrëngim i madh, i atillë që nuk është bërë që në fillim të botës e deri tani, as nuk do të bëhet.

-Joani 3, 16. Sepse Perëndia aq e deshi botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin.

-Joani 14, 19. Edhe pak, dhe bota nuk më sheh më; po ju më shihni.

-Joani 14, 30. Më nuk do të flas bashkë me ju; sepse po vjen urdhëruesi i kësaj bote, dhe nuk ka të bëjë asgjë me mua.

-Joani 15, 19. Të ishit prej botës, bota do të donte të sajën; po meqenëse nuk jeni

-Joani 18, 36. Mbretëria ime nuk është prej kësaj bote; po të ishte prej kësaj bote mbretëria ime.

-Romakëve 1, 20. Qëkurse u bë bota, duken kthjellët duke u marrë me mend me anë të atyre që janë bërë.

-Romakëve 4, 13. Sepse premtimi Abrahamit ose farës së tij se do të jetë trashëgimtari i botës.

-1 Korintasve 4, 9. Sepse u bëmë lojë në botë, në engjëjt e në njerëzit.

-2 Korintasve 4, 4. Sepse Perëndia i kësaj jete ua verboi mendimet atyre që s'besojnë.

Braktis.

-Matheu 27, 46. Perëndia im, Perëndia im, pse hoqe dorë prej meje?

-Hebrenjve 10, 25. Edhe le të mos lëmë mbledhjen tonë të përbashkët.

-2 Pjetrit 2, 15. Duke lënë udhën e drejtë, u gabuan, e shkuan pas udhës së Balaamit.

Bukë.

-Matheu 4, 4. Njeriu nuk do të rrojë vetëm me bukë.

-Matheu 16, 12. Atëherë e kuptuan, se nuk u tha të ruhen nga brumi i bukës.

-Matheu 26, 26. Jisui mori bukën, dhe si e bekoi, e theu, dhe ua dha nxënësve.

-Lluka 9, 13. Tek ne nuk gjenden më tepër se pesë bukë e dy peshq.

-Joani 6, 35. Edhe Jisui u tha atyre: Unë jam buka e jetës.

-1 Korintasve 10, 17. Sepse ne të shumtët jemi një bukë, një trup; sepse të gjithë kemi pjesë nga e njëjta bukë.

-1 Korintasve 11, 26. Sepse sa herë të hani këtë bukë, dhe të pini këtë kupë.

Burim.

-Joani 4, 14. Por uji, që do t'i jap unë, do t'i bëhet burim uji që buron për jetë të përjetshme.

-2 Pjetrit 2, 17. Këta janë kroje pa ujë, re që shtyhen prej ere të forte.

-Zbulesa 7, 17. Do t'i udhëheqë ata në burime ujërash të gjalla.

-Zbulesa 16, 4. Edhe i treti derdhi shishen e tij nëpër lumejtë e nëpër burimet e ujërave.

-Jakovit 3, 11. A mos burimi prej po asaj vrime buron ujë të ëmbël dhe të hidhur?

C

Caktoj.

-Lluka 10, 1. Edhe pastaj Zoti vuri edhe shtatëdhjetë nxënës të tjerë dhe i dërgoi dy nga dy.

-Veprat e Apostujve 17, 31. Sepse caktoi një ditë, në të cilën do të gjykojë botën me drejtësi.

-2 Korintasve 10, 13. Por sipas masës së rregullit që na caktoi Perëndia.

-1 Timotheut 1, 12. Se më konsideroi për besnik e më vuri në shërbim mua.

Cezar.

-Matheu 22, 17. Eshtë e udhës t'i japim taksë Cezarit, apo jo?

-Marku 12, 17. Jepni Cezarit ato që janë të Cezarit, dhe Perëndisë ato që janë të Perëndisë.

-Lluka 2, 1. Doli urdhër prej Qezarit August të regjistrohesh gjithë bota.

-Lluka 20, 25. Jepini pra Cezarit ato që janë të Cezarit, dhe Perëndisë ato që janë të Perëndisë.

-Lluka 23, 2. Duke ndaluar njerëzit t'i japin taksa Cezarit.

-Joani 19, 12. Në lëshofsh këtë, nuk je miku i Cezarit; gjithkush që bën veten e tij mbret, flet kundër Cezarit.

-Joani 19, 25. S'kemi tjetër mbret veç Cezarit.

Cezare.

-Matheu 16, 13. Edhe Jisui, kur erdhi në anët e Cezaresë së Filipit.

-Veprat e Apostujve 10, 1. Edhe ishte një njeri në Cezare që quhej Kornil.

-Veprat e Apostujve 23, 23. Bëni gati dyqind ushtarë për të shkuar deri në Cezare.

Ç

Çati.

-Marku 2, 4. Zbuluan kulmin ku ishte ai, edhe si bënë një vrimë, zbritën shtratin, mbi të cilin dergjej i paralizuari.

-Lluka 7, 6. Zot, mos u mundo, sepse nuk jam i zoti që të hysh nën strehën time.

Çelës.

-Matheu 16, 19. Edhe do të të jap ty kyçet e mbretërisë së qiejve.

-Lluka 11, 52. Sepse ngritët çelësin e dijes.

-Zbulesa 1, 18. Edhe kam çelësat e hadit dhe të vdekjes.

-Zbulesa 3, 7. Ai që ka çelësin e Davidit; ai që hap, dhe askush s'mbyll.

-Zbulesa 9, 1. Iu dha atij çelësi i pusit të pafundësisë.

-Zbulesa 20, 1. Edhe pashë një engjëll duke zbritur nga qielli,

i cili kishte çelësin e pafundësisë.

Çudi.

-Veprat e Apostujve 2, 22. Njeri të treguar tek ju nga Perëndia me fuqira e me çudira e me shenja.

-Hebrenjve 2, 4. Edhe Zoti dëshmonte bashkë me shenja e me çudira.

-1 Pjetrit 4, 4. Edhe prandaj u vjen çudi atyre.

-1 Pjetrit 4, 12. Të dashur, mos t'ju vijë çudi për zjarrin që u bë tek ju.

D

Damask.

-Veprat e Apostujve 9, 2. Lypi prej atij letra për sinagogat në Damask.

-Veprat e Apostujve 9, 3. Edhe duke shkuar tek afrohej në Damask.

-Veprat e Apostujve 9, 8. Duke e hequr atë prej dore, e prunë në Damask.

-Veprat e Apostujve 9, 10. Edhe ishte në Damask një nxënës që quhej Anania.

-Veprat e Apostujve 9, 19. Edhe Sauli ndenji disa ditë bashkë me nxënësit që ishin në Damask.

-Veprat e Apostujve 9, 22. Judenjtë që rrinin në Damask.

-Veprat e Apostujve 9, 27. Në Damask fliste me guxim në emrin e Jisuit.

Darkë.

-Matheu 23, 6. Edhe duan kreun e mësallës nëpër darkat dhe vendet e para nëpër sinagoga.

-Marku 6, 21. Edhe kur erdhi një ditë e mbarë në të cilën Irodi u bëri darkë.

-Lluka 14, 12. Kur të bësh drekë a darkë, mos thirr miqtë e tu, as vëllezërit e tu.

-Lluka 14, 16. Një njeri bëri një darkë të madhe dhe ftoi shumë.

-Lluka 22, 20. Kështu, pasi hëngrën mori edhe potirin, duke thënë.

-Joani 13, 4. Ngrihet nga darka, dhe zhvesh rrobat e tij.

-1 Korintasve 11, 20. Kur mbliidheni pra bashkë në të, kjo nuk është për të ngrënë darkën e Zotit.

-1 Korintasve 11, 21. Sepse për të ngrënë secili merr darkën e vet.

-Zbulesa 19, 9. Lum ata që janë ftuar në dasmën e Qengjit.

-Zbulesa 19, 17. Ejani mblidhuni në darkën e Perëndisë së madh.

Dasmë.

-Matheu 22, 2. Mbretëria e qiejve ngjan me një njeri mbret, i cili bëri dasmë për të birin e tij.

-Joani 2, 1. Edhe të tretën ditë u bë dasmë në Kana të Galilesë.

Dashuri.

-Matheu 24, 12. Edhe pasi të shumohet paligjshmëria, dashuria e të shumtëve do të ftohet.

-Joani 15, 13. Askush s'ka dashuri më të madhe se kjo, të vërë ndonjë jetën e tij për miqtë e tij.

-Romakëve 8, 39. As lartësi, as thellësi, as ndonjë tjetër krijesë nuk do të mundë të na

ndajë nga dashuria e Perëndisë.

-Romakëve 13, 10. Dashuria nuk i bën keq të afërmit; dashuria pra është përmbushja e ligjit.

-1 Korintasve 13, 4. Dashuria është zemërgjerë dhe bën të mira; dashuria nuk ka smirë; dashuria nuk mburret, nuk fryhet.

-1 Korintasve 13, 13. Edhe tani mbetet besimi, shpresa, dashuria, këto të tria; po më e madhja nga këto është dashuria.

-1 Pjetrit 4, 8. Edhe përmbi të gjitha kijeni të zjarrtë dashurinë në mes tuaj; sepse “dashuria do të mbulojë një shumicë mëkatesh”.

-1 Joanit 4, 8. Ai që nuk ka dashuri, nuk e njohu Perëndinë; sepse Perëndia është dashuri.

-1 Joanit 5, 3. Sepse kjo është dashuria e Perëndisë, të ruajmë porositë e tij.

-Zbulesa 2, 4. Po diçka kam kundër teje, sepse e le dashurinë tënde të parë.

David

-Matheu 21, 9. Hosana birit të Davidit. I bekuar është ai që vjen në emrin e Zotit.

-Lluka 20, 41. Si thonë, se Krishti është bir i Davidit?

-Veprat e Apostujve 2, 29. O burra vëllezër, mund t'ju them me guxim për kryeatin David.

-Veprat e Apostujve 2, 34. Sepse Davidi nuk u ngjit në qiejt.

Dekapoli.

-Matheu 4, 25. Edhe i shkuan pas shumë njerëz nga Galilea e nga Dekapoli.

-Marku 5, 20. Dhe ai iku e zuri të predikojë në Dekapol sa i bëri atij Jisui.

-Marku 7, 31. Erdhi buzë detit të Galileësë përmes kufijve të Dekapolit.

Dele.

-Matheu 9, 36. Sepse ishin lodhur e shpërndarë si dhen që s'kanë bari.

-Matheu 10, 6. Por shkoni më tepër nëpër dhentë e humbura të shtëpisë së Izraelit.

-Matheu 10, 16. Ja tek po ju dërgoj unë ju si dhen në mes të ujqërve.

-Matheu 18, 12. Në pastë ndonjë njeri njëqind dhen, edhe t'i humbasë një nga ato.

-Matheu 25, 32. Do t'i ndajë ata njërin nga tjetri, siç ndan bariu dhentë nga kecat.

-Matheu 26, 31. Do të godas bariun dhe dhentë e tufës do të shpërndahen.

-Joani 10, 16. Kam edhe të tjera dhen, të cilat s'janë prej këtij oborri.

-Joani 21, 16. I thotë: Ruaj dhentë e mia.

-Veprat e Apostujve 8, 32. U pru si dele për therje, dhe si qengj pa zë përpara atij që e qeth.

-Romakëve 8, 36. Se për ty vritemi gjithë ditën; u numëruam porsì dhen për të therur.

-1 Pjetrit 2, 25. Sepse ishit “si dhen të arratur”, po tani u kthyet te bariu.

Demon.

-Matheu 12, 24. Ky nuk i nxjerr djajtë, veçse me anë të Velzevulit, të parit të djajve.

-Marku 1, 32. Prunë tek ai gjithë ata që kishin keq dhe të demonizuarit.

-Lluka 8, 36. U treguan dhe ata që e panë, si shpëtoi i demonizuari.

-1 Korintasve 10, 20. Ua bëjnë theror djajve, e jo Perëndisë.

-1 Korintasve 10, 21. S’mund të pini kupën e Zotit dhe kupën e djajve; nuk mund të jeni pjesëtarë të tryezës së Zotit dhe të tryezës së djajve.

-1 Timotheut 4, 1. Do t’u mbajnë vesh shpirtave gënjeshtarë, dhe mësimëve të djajve.

-Jakovit 2, 19. Ti beson se Perëndia është një; mirë bën; edhe djajtë besojnë, dhe dridhen.

-Zbulesa 16, 14. Sepse janë frymë djajsh që bëjnë shenja.

-Zbulesa 18, 2. U bë banesë djajsh dhe strofkë e çdo fryme të ndyrë.

Denar.

-Matheu 20, 9. Edhe erdhën ata që ishin pajtuar rreth orës së njëmbëdhjetë, dhe morën nga një dinar.

-Matheu 20, 10. Po edhe ata morën nga një dinar.

-Matheu 22, 20. Edhe ata i prunë një dinar.

-Marku 12, 15. Sillmëni një dinar që ta shoh.

-Lluka 20, 24. Tregomëni një dinar.

Dënoj.

-Matheu 12, 37. Nga fjalët e tua do të dënohesh.

-Matheu 12, 7. Muk do t'i kishit dënuar të pafajshmit.

-Matheu 20, 18. Dhe do ta dënojnë me vdekje.

-Lluka 6, 37. Mos dënoni, dhe nuk do të dënoheni.

-Romakëve 5, 18. Sikurse pra, me anë të një faji erdhi dënim në gjithë njerëzit.

-Romakëve 8, 1. Tani pra s'ka ndonjë dënim për ata.

-Romakëve 8, 3. Dënoi mëkatën në mish.

-2 Korintasve 1, 9. Po ne në veten tonë kishim marrë vendimin e vdekjes.

-2 Korintasve 3, 9. Sepse në qoftë se shërbesa e dënimit është lavdi.

-Titit 3, 11. Dhe mëkaton, sepse e ka dënuar veten.

-Jakovi 5, 6. Dënuat dhe vratë të drejtin; dhe ai nuk ju rri kundër.

Dëshmi.

-Matheu 10, 8. Për dëshmi mbi ata dhe mbi kombet.

-Matheu 24, 14. Për dëshmi mbi gjithë kombet.

-Joani 4, 44. Sepse vetë Jisui dëshmoi se asnjë profet s'ka nder në atdheun e tij.

-Joani 8, 17. Edhe në ligjin tuaj është shkruar se dëshmia e dy njerëzve është e vërtetë.

-Joani 18, 37. Që të dëshmoj për të vërtetën.

-Veprat e Apostujve 13, 31. Të cilët janë dëshmitarë të tij tek populli.

-Romakëve 8, 16. Vetë Shpirti dëshmon bashkë me shpirtin tonë se jemi bij Perëndie.

-1 Timotheut 3, 7. Dhe duhet të ketë dëshmi të mire.

-2 Timotheut 1, 8. Mos ki turp pra për dëshminë e Zotit tone.

-Hebrenjve 7, 8. Po atje merr të dhjeta ai që dëshmohet se rron.

-1 Joanit 5, 7. Sepse tre janë ata që dëshmojnë në qiell.

-Zbulesa 12, 17. Të cilët ruajnë porosinë e Perëndisë dhe që kanë dëshminë e Jisuit.

-Zbulesa 19, 10. Që kanë dëshminë e Jisuit.

-Zbulesa 20, 4. Pashë shpirtat e atyre që ishin therur për dëshminë e Jisuit.

Dishepull.

-Matheu 10, 24. Nuk është nxënësi përmbi mësuesin, as shërbëtori përmbi të zotin.

-Matheu 26, 26. Jisui mori bukën, dhe si e bekoi, e theu, dhe ua dha nxënësve e tha.

-Matheu 26, 56. Atëherë gjithë nxënësit e lanë dhe ikën.

-Joani 8, 31. Jeni me të vërtetë nxënësit e mi.

Divorc.

-Matheu 1, 19. Duke mos dashur t'i nxjerrë asaj zë të lig, deshi ta lëshojë fshehurazi.

-Matheu 5, 31. Ai që të lërë gruan e tij, le t'i japë asaj letrën e ndarjes.

-Matheu 19, 7. Moisiu ka porositur t'i japë burri gruas kartën e ndarjes dhe ta lëshojë?

-Matheu 19, 9. Ai që lëshon gruan e tij, përveçse për punë imoraliteti.

-Marku 10, 11. Kush të lërë gruan e tij e të martohet me tjetër, bën imoralitet me atë.

-Lluka 16, 18. Kushdo që lë gruan e tij dhe martohet me tjetër.

Djall.

-Matheu 4, 1. U pru në shkretëtirë prej Shpirtit, që të ngitej prej djallit.

-Matheu 25, 41. Që është bërë gati për djallin e për engjëjt e tij.

-Joani 8, 44. Ju jeni prej djallit, atit tuaj, dhe doni të bëni dëshirat e atit tuaj.

-Joani 13, 2. Djalli tanimë kishte vënë në zemrën e Juda Iskariotit.

-Efesianëve 4, 27. As mos i bëni vend djallit.

-Efesianëve 6, 11. Që të mundeni t'u qëndroni kundër mjeshtërive të djallit.

-Hebrenjve 2, 14. Atë që ka pushtetin e vdekjes, domethënë djallin.

-Jakovi 4, 7. Bindjuni pra Perëndisë; rri kundër djallit.

-1 Pjetrit 5, 8. Përmbani veten, rri zgjuar; sepse ndërgjyqësi juaj, djalli, si luan që ulërin.

-1 Joanit 3, 8. Ai që bën mëkatin, është nga djalli,

-Zbulesa 12, 12. Mjerë ju tokë e det, se zbriti djalli tek ju.

-Zbulesa 20, 2. Gjarpërin e vjetër, i cili është djalli dhe Satanai.

Drejtësi.

-Matheu 5, 10. Lum ata që ndiqen për punë drejtësie.

-Joani 16, 8. Do të qortojë botën për faj dhe për drejtësi.

-Veprat e Apostujve 10, 35. Ai që ka frikë prej tij dhe punon drejtësi.

-Veprat e Apostujve 17, 31. Do të gjykojë botën me drejtësi.

-Romakëve 1, 17. Sepse me anë të tij zbulohet drejtësia e Perëndisë.

-Romakëve 10, 3. Sepse duke mos njohur drejtësinë e Perëndisë.

-Romakëve 10, 4. Sepse fundi i ligjit është Krishti për drejtësi.

-Romakëve 10, 5. Sepse Moisiu shkruan për drejtësinë që është prej ligjit.

-Romakëve 10, 6. Po drejtësia që është prej besimit thotë kështu.

-1 Korintasve 15, 34. Zgjohuni në të drejtën dhe mos mëkatoni.

-2 Timotheut 3, 16. Për qortim, për ndreqje, për arsim që është me drejtësi.

-Hebrenjve 2, 2. Çdo shkelje porosie e mosdëgjim mori shpërblim të drejtë.

-1 Pjetrit 2, 23. Jepte veten në dorën e atij që gjykon me drejtësi.

-1 Pjetrit 3, 14. Po edhe nëse hiqni keq për drejtësinë.

-2 Pjetrit 3, 13. Presim qiej të rinj dhe tokë të re, në të cilët rri drejtësia.

-Zbulesa 10, 11. Me drejtësi gjykon e lufton.

Dritë.

-Matheu 5, 16. Kështu le të ndriçojë drita juaj përpara njerëzve.

-Joani 3, 19. Edhe ky është gjyqi, se drita erdhi në botë.

-Joani 8, 12. Unë jam drita e botës.

-2 Korintasve 4, 6. Sepse Perëndia që tha të ndiçojë dritë nga errësira.

-2 Korintasve 11, 14. Vetë Satanai ndërron formën në engjëll drite.

-1 Timotheut 6, 16. Që rri në dritë të paafueshme.

-Jakovi 1, 17. Zbret nga Ati i dritave.

-1 Pjetrit 2, 9. Që ju thirri nga
errësira në dritën e tij të
çuditshme.

DH

Dhembje.

-Matheu 24, 8. Por të gjitha
këto janë fillimi i dhimbjeve.

-Galatasve 4, 27. Bërtit e
thërrit ti që nuk ke dhimbje
lindjeje.

-Zbulesa 12, 2. Bërtiste nga
dhimbjet e barkut.

-Zbulesa 21, 4. As dhimbje nuk
do të ketë më.

Dhjetë.

-Matheu 23, 23. Sepse jepni
të dhjetën e menders.

-Hebrenjve 7, 5. Kanë porosi
të marrin sipas ligjit të dhjetën
nga populli.

-Hebrenjve 7, 9. Që merr të
dhjeta, dha të dhjeta.

-Zbulesa 5, 11. Edhe numri i
tyre ishte dhjetë mijëra dhjetë
mijërash, e mijëra mijërash.

Dhuratë.

-Matheu 19, 11. Nuk mund ta presin këtë fjalë të gjithë, por ata të cilëve u është dhënë.

-Veprat e Apostujve 8, 20. Sepse pandehe se dhurata e Perëndisë fitohet me aspra.

-Romakëve 5, 16. Edhe dhurata nuk është si puna.

-Romakëve 6, 23. Po dhurata e Perëndisë jetë e përjetshme.

-1 Korintasve 7, 7. Secili ka dhuratë të veçantë nga Perëndia.

-1 Korintasve 12, 4. Edhe dhuratat janë të ndara.

-1 Korintasve 14, 12. Meqë jeni të zellshën për dhuratat shpirtërore.

-1 Timotheut 4, 4. Mos ji i pakujdesshëm për dhuratën që është tek ti.

-Hebrenjve 6, 4. Ndjenë shijen e dhuratës qiellore.

-Hebrenjve 11, 4. Me anë të së cilës mori dëshmi për dhuratat e tij.

-Jakovit 1, 17. Çdo dhënie e mirë, dhe çdo dhuratë e përsosur.

- Zbulesa 11, 10. Do t'i dërgojnë dhurata njëri-tjetrit.

E

Efes.

-1 Korintasve 15, 32. Nëse si njeri luftova me bisha në Efes.

-Zbulesa 2, 1. Shkruajti engjëllit të kishës së Efesit.

Emanuel.

-Matheu 1, 23. Do të lindë djalë, dhe do t'ia vënë emrin Emanuel.

Emaus.

-Lluka 24, 13. Duke shkuar atë ditë në një fshat që quhej Emaus.

Emër.

-Matheu 6, 9. Ati ynë që je në qiejt, u shenjtëroftë emri yt.

-Matheu 12, 21. Edhe kombet do të shpresojnë në emrin e tij.

-Matheu 24, 9. Do t'ju kenë mëri gjithë kombet për emrin tim.

-Lluka 21, 12. Përpara mbretërve e qeveritarëve për shkak të emrit tim.

-Joani 14, 14. Nëse lypni gjë në emrin tim, unë do ta bëj.

-Joani 17, 26. Edhe u tregova atyre emrin tend.

-Veprat e Apostujve 4, 12. Sepse asnjë tjetër emër nën qiell.

-Veprat e Apostujve 15, 14. Që të marrë prej tyre një popull për emrin e tij.

-Romakëve 10, 13. Sepse kushdo që të thërresë emrin e Zotit, do të shpëtojë.

-2 Korintasve 6, 8. Në emër të mirë e në emër të keq.

Engjëll.

-Matheu 22, 30. Janë si engjëjt të Perëndisë në qiell.

-Matheu 28, 2. Sepse engjëlli i Zotit zbriti nga qielli.

-Veprat e Apostujve 5, 19. Po një engjëll i Zotit natën hapi dyert e burgut.

-1 Korintasve 4, 9. Në engjëjt e në njerëzit.

-1 Korintasve 6, 3. A nuk e dini se do të gjykojmë engjëjt?

-2 Korintasve 11, 14. Satanai ndërron formën në engjëll drite.

-2 Korintasve 12, 7. Një gjemb në trup, engjëll satana.

-Hebrenjve 13, 2. Sepse me anë të kësaj disa pa e ditur pritën engjëjt.

-1 Pjetrit 1, 12. Gjëra në të cilat engjëjt dëshirojnë të përkulen e t'i shohin.

-2 Pjetrit 2, 4. Sepse nëse Perëndia nuk kurseu engjëjt që mëkatuan.

-Zbulesa 22, 6. Dërgoi engjëllin e tij.

Etje.

-Matheu 5, 6. Lum ata që kanë uri e etje për drejtësinë.

-Joani 7, 37. Kush të ketë etje, le të vijë tek unë e le të pijë.

-Zbulesa 7, 16. Nuk do të kenë uri, as nuk do të kenë më etje.

-Zbulesa 21, 6. Unë do t'i jap falas nga burimi i ujit të jetës atij që ka etje.

-Zbulesa 22, 17. Dhe ai që ka etje, le të vijë.

Eunuk.

-Matheu 19, 12. Sepse ka eunukë që kanë lindur kështu që nga barku i nënës; dhe ka eunukë që u bënë të tillë nga njerëzit; dhe ka eunukë që e bënë të tillë veten e tyre për mbretërinë e qiejve.

-Veprat e Apostujve 8, 27. Edhe ja një njeri Etiopian, eunuk.

Eva.

-2 Korintasve 11, 3. Ashtu si gjarpëri gënjeu Evën me dinakërinë e tij.

-1 Timotheut 2, 13. Sepse
përpara u gatua Adami, pastaj
Eva.

Ë

Ëndërr.

-Veprat e Apostujve 2, 17.
Pleqtë tuaj do të ëndërrojnë
ëndrra.

F

Faj.

-Joani 18, 38. Unë nuk gjej ndonjë faj tek ai.

-Veprat e Apostujve 24, 16. Ndërgjegje pa brejtje përpara Perëndisë dhe përpara njerëzve.

Fal.

-Matheu 6, 12. Falna fajet tona, sikurse edhe ne ua falim fajtorëve tanë.

-Matheu 9, 6. Po që ta dini se i biri i njeriut ka pushtet mbi dhe të falë mëkate.

-Matheu 12, 31. Çdo faj e çdo sharje do t'u ndjehet njerëzve.

-Matheu 26, 28. Që derdhet për shumë veta për ndjesën e mëkateve.

-Marku 1, 4. Duke predikuar pagëzim pendimi për ndjesën e fajeve.

-Marku 2, 7. Cili mund të falë mëkate, përveçse një, Perëndia?

-Marku 11, 25. Ati juaj që është në qiejt t'ju ndjejë juve fajet tuaja.

-Lluka 1, 77. Me anë të ndjesës së mëkateve.

-Lluka 24, 47. Ndjesë mëkatesh mbi gjithë kombet.

-Joani 20, 23. Kujtdo që t'u falni mëkatet, u janë falur atyre.

-Veprat e Apostujve 2, 38. Për ndjesën e mëkateve.

-Veprat e Apostujve 10, 43. Do të marrë ndjesë mëkatesh kushdo që i beson atij.

-Hebrenjve 9, 22. Pa derdhur gjak s'ka ndjesë mëkatesh.

-Hebrenjve 10, 18. Edhe kur ka ndjesë të këtyre, nuk ka më dhuratë për mëkat.

-Jakovi 5, 15. Në pastë bërë mëkate, do t'i falen.

-1 Joanit 1, 9. Që të na ndjejë mëkatet dhe të na pastrojë nga çdo padrejtësi.

Falas.

-Matheu 10, 8. Shëroni të sëmurë, pastroni lebrozë, ngjallni të vdekur, nxirrni djaj; falas morët, falas jepni.

-Romakëve 3, 24. Dalin të drejtë falas me anë të hirit të tij.

-1 Korintasve 9, 18. Që të predikoj ungjillin e Krishtit pa pagesë.

-Zbulesa 21, 6. Unë do t'i jap falas nga burimi i ujit të jetës atij që ka etje.

-Zbulesa 22, 17. Dhe ai që do, le të marrë falas ujin e jetës.

Falënderoj.

-Matheu 26, 27. Edhe mori potirin, dhe si falënderoi, ua dha atyre.

-Joani 11, 41. Atë, të falënderit se më dëgjove.

-Veprat e Apostujve 28, 15. Kur i pa Pavli, falënderoi Perëndinë, dhe mori zemër.

-Romakëve 14, 6. Ai që nuk ha, për Zotin nuk ha, dhe falënderon Perëndinë.

-1 Korintasve 1, 4. Falënderoj përherë Perëndinë tim për ju.

-1 Korintasve 10, 30. Edhe nëse unë marr pjesë në falënderim, përse të shahem për atë që falënderoj?

-Efesianëve 5, 20. Duke falënderuar Perëndinë dhe Atin në emrin e Zotit tonë Jisu Krisht.

-1 Timotheut 4, 4. Po të merret me falënderime.

-Zbulesa 11, 17. Të falënderit ty, o Zot Perëndi i Gjithëpushtetshëm.

Farë.

-Matheu 13, 38. Ara është bota; dhe fara e mirë.

-Lluka 8, 11. Fara është fjala e Perëndisë.

-Romakëve 9, 7. Sepse janë farë e Abrahamit.

-Romakëve 9, 29. Po të mos na kishte lënë farë Zoti Savaoth.

-1 Korintasve 15, 38. Gjithësecilës nga farat trupin e saj të veçantë.

-Galatasve 3, 16. Premtimet iu thanë Abrahamit dhe farës së tij.

-Galatasve 3, 19. Deri sa të vinte fara.

-Galatasve 3, 29. Jeni farë e Abrahamit dhe sipas premtimit trashëgimtarë.

-Zbulesa 12, 17. Ata që mbetën prej farës së saj.

Farise.

-Matheu 5, 20. Më tepër se ajo e shkruesve dhe e Farisenjve.

-Matheu 12, 14. Po Farisenjtë dolën e bënë këshillë kundër atij, që ta zhdukin.

-Matheu 23, 15. Mjerë ju shkrues e Farisenj, hipokritë.

-Matheu 23, 26. Farise i verbër, pastro më përpara atë që është brenda në gotë.

-Lluka 5, 21. Edhe shkruesit e Farisenjtë zunë të mendoheshin.

-Lluka 18, 11. Fariseu ndenji e falej me veten e tij.

-Joani 12, 42. Po nga frika e Farisenjve nuk rrëfenin.

Fëmijë.

-Matheu 11, 25. Ua fshehe këto të diturve e të mençurve, dhe ua zbulove ato foshnjave.

-Matheu 18, 3. Në mos u kthefshi e të bëheni si djemtë e vegjël.

-Matheu 19, 14. Lërimi fëmijët e vegjël, dhe mos i ndaloni të vijnë tek unë.

-Matheu 21, 16. Se nga goja e fëmijëve dhe e foshnjave bëre gati lavdërim.

-Lluka 9, 47. Zuri prej dore një djalë, dhe e vuri pranë vetes së tij.

-Romakëve 8, 16. Vetë Shpirti dëshmon bashkë me shpirtin tonë se jemi bij Perëndie.

-1 Korintasve 3, 1. Si njerëzve truporë, si foshnjeve në Krishtin.

-1 Korintasve 13, 11. Kur isha foshnje, si foshnje flisja, si foshnje kuptoja, si foshnje mendohesha; po kur u bëra burrë, i lashë mënjanë punët e fëmijës.

-Efesianëve 5, 9. Ecnit si bij drite, sepse fryti i Shpirtit është në çdo mirësi.

-Efesianëve 6, 1. Ju bij, bindjuni prindërve tuaj në Zotin.

-Efesianëve 6, 4. Edhe ju etërit mos zemëroni bijtë tuaj.

-1 Joanit 5, 21. Bij, ruhuni nga idhujt.

-Zbulesa 12, 5. Edhe lindi një fëmijë mashkull.

Fitoj.

-Matheu 16, 26. Sepse ç' dobi ka njeriu, në fitoftë tërë botën.

-Lluka 20, 35. Po ata që u bënë të zotët të fitojnë atë jetë dhe ngjalljen.

-Lluka 21, 19. Me durimin tuaj do të fitoni shpirtin tuaj.

-1 Korintasve 9, 20. Edhe u bëra tek Judenjtë si Judeas, që të fitoj Judenjtë.

-1 Korintasve 9, 24. Tek të dobëtit u bëra si i dobët, që të fitoj të dobëtit.

-1 Pjetrit 3, 1. Të fitohen pa fjalë nga sjelljet e grave.

-Zbulesa 12, 8. Edhe nuk fituan, as u gjet vend për ata në qiell.

Flijim.

-Matheu 9, 13. Edhe shkoni e mësoni ç' është "Dua përdëllim, e jo theror".

-Romakëve 12, 1. T'i tregoni trupat tuaj therorë të gjallë, të shenjtë, të pëlqyeshëm për Perëndinë.

-Hebrenjve 10, 1. S'mundet kurrë me anë të po atyre therorëve.

-Hebrenjve 10, 12. Po ai, pasi ofroi një theror për mëkate.

-Hebrenjve 10, 26. Nuk mbetet më theror për mëkate.

-Hebrenjve 13, 15. Sepse therore të tilla pëlqen Perëndia.

1 Pjetrit 2, 5. Që të ofroni therorë shpirtërorë, që i pëlqejnë Perëndisë.

Frikë.

-Romakëve 13, 7. Atij që i keni detyrim frikën, frikën; atij që i keni detyrim nderin, nderin.

-Hebrenjve 13, 6. Zoti është ndihmësi im, dhe nuk do të kem frikë.

-Filipianëve 2, 12. Punoni për shpëtimin e vetes suaj me frikë e me dridhje.

-1 Joanit 4, 18. Frikë nuk ka në dashuri, por dashuria e përsosur e nxjerr jashtë frikën, sepse frika ka mundim dhe ai që ka frikë nuk është i përsosur në dashuri.

Frymë.

-Matheu 3, 16. Edhe ja tek u hapën qiejt dhe pa Shpirtin e Perëndisë duke zbritur si pëllumb.

-Matheu 26, 41. Sepse shpirti im është i gatshëm, po mishi është i pafuqishëm.

-Lluka 24, 39. Se shpirti s'ka mish e eshtra, siç më shihni mua se kam.

-Joani 4, 24. Perëndia është shpirt, dhe ata që i falen duhet të falen me shpirt e me të vërtetë.

-Veprat e Apostujve 2, 17. Edhe në ditën e fundit, thotë

Perëndia, do të derdh nga Shpirti im mbi çdo mish.

-Veprat e Apostujve 7, 51. Ju gjithnjë i rri kundër Shpirtit të Shenjtë.

-Romakëve 8, 6. Sepse mendimi i mishit është vdekje, por mendimi i Shpirtit është jetë dhe paqe.

-Romakëve 8, 9. Po ju nuk jeni të mishit, po të Shpirtit, në qoftë se rri Shpirti i Perëndisë tek ju. Po nëse nuk ka ndonjë Shpirtin e Krishtit, ky nuk është i atij.

-Romakëve 8, 11. Po në rri tek ju Shpirti i atij që ngjalli Jisuin prej së vdekurish, ai që ngjalli Krishtin prej së vdekurish do t'u japë jetë edhe trupave tuaj të vdekshëm, me anë të Shpirtit të tij që rri në ju.

-Romakëve 8, 16. Vetë Shpirti dëshmon bashkë me shpirtin tonë se jemi bij Perëndie.

-1 Korintasve 2, 10. Po Perëndia na i zbuloi me anë të

Shpirtit të tij; sepse Shpirti i vëzhgon të gjitha, edhe thellësitë e Perëndisë.

-1 Korintasve 2, 11. Sepse cili prej njerëzve i njeh punët e njeriut, përveçse shpirti i njeriut që është në të? Kështu edhe punët e Perëndisë asnjë s'i njeh, përveçse Shpirti i Perëndisë.

-1 Korintasve 3, 16. Nuk e dini se jeni tempull Perëndie, dhe Shpirti i Shenjtë rri tek ju?

-2 Korintasve 3, 6. Jo të shkronjës, por të shpirtit; sepse shkronja vret, kurse shpirti jep jetë.

-2 Korintasve 3, 17. Dhe Zoti është Shpirti; dhe ku është Shpirti i Zotit, atje ka liri.

-Efesianëve 2, 22. Banesë e Perëndisë me anë të Shpirtit.

-Efesianëve 4, 30. Edhe mos hidhëroni Shpirtin e Shenjtë të Perëndisë.

-Efesianëve 6, 17. Edhe merrni përkrenaren e shpëtimit, dhe thikën e Shpirtit, që është fjala e Perëndisë.

-2 Timotheut 1, 7. Sepse Perëndia s'na ka dhënë shpirt frike, po fuqie dhe dashurie e urtësie.

-Jakovi 4, 5. Për smirë dëshiron shpirti që ndenji ndër ne?

-1 Pjetrit 3, 19. Shkoi të predikonte edhe tek shpirtrat që ishin në burg.

-Zbulesa 22, 17. Edhe Shpirti dhe nusja thonë: Eja.

Fryt.

-Matheu 7, 19. Çdo dru që s'bën pemë të mirë pritet e hidhet në zjarr.

-Matheu 7, 20. Prandaj nga pemët e tyre do t'i njihni ata.

-Matheu 21, 43. Do t'i jepet një kombi që bën pemët e saj.

-Matheu 26, 29. Nuk kam për të pirë që tani e tutje nga kjo pemë, që pjell hardhia.

-Lluka 3, 8. Bëni pra pemë të vlefshme për pendim.

-Joani 4, 36. Edhe ai që korr merr pagë, dhe mbledh pemë për jetë të përjetshme.

-Joani 15, 2. Çdo hardhi që nuk sjell pemë, e këput; dhe çdo hardhi që sjell pemë, e pastron, që të sjellë më tepër pemë.

-Romakëve 7, 4. Që të sjellim fryte tek Perëndia.

-Galatasve 5, 22. Por fryti i Shpirtit është dashuri.

-Hebrenjve 13, 15. Domethënë fryt buzësh që rrëfejnë emrin e tij.

Fuqi.

-Matheu 24, 29. Yjet do të bien nga qielli, dhe fuqitë e qiejve do të tunden.

- Lluka 1, 35. Shpirti i Shenjtë do të vijë mbi ty, dhe fuqia e të Lartit do të të hiesojë.
- Veprat e Apostujve 1, 8. Por do të merrni fuqi, kur të vijë Shpirti i Shenjtë mbi ju.
- Romakëve 1, 16. Sepse nuk kam turp për ungjillin e Krishtit; sepse është fuqi Perëndie.
- Romakëve 8, 38. As pushtete, as fuqira, as ato që janë tani.
- Romakëve 9, 22. Të bëjë të njohur fuqinë e tij.
- 1 Korintasve 4, 20. Sepse mbretëria e Perëndisë nuk është në fjalë, po në fuqi.
- 1 Korintasve 15, 43. Ngrihet në lavdi; mbillet në dobësi, ngrihet në fuqi.
- 2 Korintasve 4, 7. Që të jetë teprimi i fuqisë nga Perëndia dhe jo nga ne.
- 2 Korintasve 12, 9. Të mjafton hiri im; sepse fuqia ime në dobësi tregohet e përsosur.
- 1 Timotheut 1, 12. Edhe falënderoj Jisu Krishtin, Zotin tonë, që më dha fuqi.
- 2 Timotheut 1, 7. Sepse Perëndia s'na ka dhënë shpirt frike, po fuqie dhe dashurie e urtësie.
- 2 Timotheut 3, 5. Që në dukje janë të përkushtuar, po fuqinë e tij e kanë mohuar.
- Hebrenjve 6, 5. Shijen e fjalës së mirë të Perëndisë, dhe të fuqive të jetës së ardhme.
- 1 Pjetrit 3, 22. Të cilit iu nënshtruan engjëjt dhe pushtetet e fuqitë.
- Zbulesa 1, 6. Atij i qoftë lavdia dhe fuqia në jetë të jetëve.
- Zbulesa 12, 10. Tani u bë shpëtimi dhe fuqia dhe mbretëria e Perëndisë.

G

Gabriel.

-Lluka 1, 19. Unë jam Gabrieli që rri përpara Perëndisë.

-Lluka 1, 26. Edhe në të gjashtin muaj, engjëlli Gabriel u dërgua prej Perëndisë.

Galile.

-Matheu 4, 23. Edhe Jisui vinte për qark gjithë Galileësë.

-Marku 14, 70. Sepse je Galileas, dhe të folurit tënd ngjan.

-Lluka 13, 1. Duke i treguar atij për Galileasit.

-Joani 2, 11. Këtë nisje të çudirave Jisui e bëri në Kana të Galileësë.

-Joani 4, 45. Kur erdhi pra në Galile, Galileasit e pritën.

-Joani 7, 41. Mos vjen Krishti nga Galilea?

Gamaliel.

-Veprat e Apostujve 5, 34. Atëherë u ngrit në kuvend një Farise, që quhej Gamaliel, mësues i ligjit.

-Veprat e Apostujve 22, 3. Lindur në Tars të Kilikisë dhe rritur në këtë qytet pranë këmbëve të Gamalielit.

Garë.

-1 Korintasve 9, 24. A nuk e dini se vrapuesit në stadium që të gjithë vrapojnë, po një e merr çmimin; kështu, vraponi që ta merrni.

-2 Timotheut 2, 5. Po edhe në luftoftë ndonjëri, nuk kurorëzohet, nëse nuk lufton sipas ligjit.

-Hebrenjve 12, 1. Me durim le të sulemi në rrugën që është përpara nesh.

Gënjeshtër.

-Joani 8, 44. Kur flet gënjeshtër, flet nga të tija; sepse është gënjeshtar, dhe i ati i saj, i gënjeshtres.

-Romakëve 1, 25. Të cilët ndërruan të vërtetën e Perëndisë në gënjeshtër.

-Efesianëve 4, 25. Prandaj, duke hedhur tej gënjeshtërën.

-2 Selanikasve 2, 11. Perëndia do t'u dërgojë atyre veprim mashtrimi, që t'i besojnë gënjeshtërës.

-Zbulesa 14, 5. Edhe në gojët e tyre nuk u gjet mashtrim, sepse janë pa të metë.

-Zbulesa 21, 27. Asgjë e fëlliqur dhe kush bën ndyrësi e gënjeshtër.

-Zbulesa 22, 15. Kushdo që do e bën gënjeshtërën.

Gëzim.

-Lluka 2, 10. Lajmin e mirë për një gëzim të madh.

-Joani 16, 22. Zemra juaj do të gëzohet, dhe asnjë nuk e ngre gëzimin tuaj prej jush.

-2 Korintasve 7, 4. Ndjej gëzim shumë të madh në gjithë hidhërimin tonë.

-Hebrenjve 10, 34. E pritët me gëzim grabitjen e kamjes suaj.

-Hebrenjve 12, 2. I cili për gëzimin që ishte përpara tij duroi kryqin.

-Hebrenjve 12, 11. Edhe çdo mundim tani nuk duket se sjell gëzim.

Gomorra.

-Matheu 10, 15. Mundimi në tokën e Sodomës e të Gomorrës në ditët e gjyqit.

-Romakëve 9, 29. Do të ishim bërë si Sodoma, dhe do të kishim ngjarë me Gomorrën.

Grazhd.

-Lluka 2, 7. E mbështolli në shpërgënj, dhe e vuri në grazhd.

-Lluka 2, 12. Një foshnjë mbështjellë në shpërgënj, shtrirë në grazhd.

-Lluka 2, 16. Mariamin dhe Josifin e foshnjën shtrirë në grazhd.

Grua.

-Matheu 11, 11. Në mes të atyre që kanë lindur prej grash.

-Matheu 24, 41. Dy gra do të bluajnë në mulli; njëra merret e tjetra lihet.

-Joani 2, 4. Jisui i thotë: Ç'ke ti me mua, o grua?

-Joani 19, 26. I thotë së ëmës: Grua, ja yt bir.

-1 Korintasve 7, 2. Po për t'u larguar nga imoralitetet le të ketë secili gruan e tij.

-1 Korintasve 7, 39. Gruaja është e lidhur nga ligji për sa kohë rron burri i saj.

-1 Korintasve 11, 3. Kryet e gruas është burri; dhe kryet e Krishtit është Perëndia.

-1 Korintasve 11, 10. Prandaj gruaja duhet të ketë pushtet mbi kryet e saj, për engjëjt.

-1 Korintasve 11, 12. Sepse sikurse gruaja është prej burrit, kështu edhe burri është me anë të gruas.

-1 Korintasve 14, 34. Gratë tuaja le të heshtin në kishë.

-Efesianëve 5, 22. Ju gratë bindjuni burrave tuaj, si Zotit.

-Efesianëve 5, 23. Sepse burri është kryet e gruas, siç është edhe Krishti kryet e kishës.

-1 Timotheut 2, 11. Gruaja le të mësohet në heshtje e me çdo lloj bindjeje.

-1 Pjetrit 3, 7. Ju burrat, gjithashtu, jetoni bashkë me gratë tuaja me urtësi, duke i nderuar gratë si enë më delicate.

-Zbulesa 12, 1. Një grua që kishte veshur diellin, dhe hëna ishte poshtë këmbëve të saj, dhe mbi kryet e asaj ishte një kurorë me dymbëdhjetë yje.

-Zbulesa 12, 17. Edhe dragoi u zemërua kundër gruas.

-Zbulesa 14, 4. Këta janë ata që nuk u ndynë me gra.

-Zbulesa 17, 3. Pashë një grua që po rrinte mbi bishën e kuqe.

-Zbulesa 21, 9. Eja, do të të tregoj ty nusen, gruan e Qengjit.

Gur.

-Matheu 21, 42. Guri që s'e pëlqyen ata që ndërtojnë, ky u bë kreu i qoshes.

-Marku 12, 10. As këtë shkrim s'e keni lexuar: “guri që s'e pëlqyen ata që ndërtojnë, ky u bë kreu i qoshes.

-Lluka 19, 40. Po ju them juve, se në pushofshin këta, gurët do të thërresin.

-Romakëve 9, 33. Sepse u penguan në gurin e pengesës.

-Efesianëve 2, 20. Ku gur qosheje është vetë Jisu Krishti.

-1 Pjetrit 2, 6. Ja tek vë në Sion një gur kryeqosheje, të zgjedhur, të çmueshëm.

-1 Pjetrit 2, 7. Për ju pra që besoni është i çmuar; po për të pabindurit “guri që hodhën tej ndërtuesit, ky u bë kreu i qoshes dhe gur pengese e gur skandali”.

Gj

Gjak.

-Matheu 23, 35. Të vijë mbi ju çdo gjak i drejtë që është derdhur mbi dhe, që nga gjaku i Abelit të drejtë e deri në gjakun e Zaharisë.

-Matheu 25, 28. Sepse ky është gjaku im i dhiatës së re.

-Matheu 27, 25. Gjaku i tij qoftë mbi ne dhe mbi bijtë tanë.

-Joani 6, 54. Ai që ha mishin tim dhe pi gjakun tim, ka jetë të përjetshme.

-Veprat e Apostujve 15, 20. Nga imoraliteti dhe nga kafsha e mbytur dhe nga gjaku.

-Veprat e Apostujve 15, 29. Të hiqni dorë nga kurbanët e idhujve dhe nga gjaku.

-Veprat e Apostujve 20, 28. Të kullotni kishën e Perëndisë, të cilën e fitoi me gjakun e tij.

-1 Korintasve 15, 50. Vëllezër, se mish dhe gjak s'mund të trashëgojë mbretërinë e Perëndisë.

-Hebrenjve 9, 20. Ky është gjaku i dhiatës që urdhëroi Perëndia për ju.

-Hebrenjve 9, 22. Edhe pothuajse me gjak të gjitha pastrohen sipas ligjit, dhe pa derdhur gjak s'ka ndjesë mëkatesh.

-1 Joanit 1, 7. Gjaku i Jisu Krishtit, Birit të tij, na pastron nga çdo mëkat.

-Zbulesa 18, 24. Edhe në të u gjet gjak profetësh e shenjtorësh.

-Zbulesa 7, 14. Zbardhën stolitë e tyre në gjakun e Qengjit.

Gjenisaret.

-Matheu 14, 34. Edhe si shkuan përtej, erdhën në dheun Gjenisaret.

-Lluka 5, 1. Ai qëndronte pranë liqenit Gjenisaret.

Gjetsemani.

-Matheu 26, 36. Atëherë Jisui vjen bashkë me ata në një fshat që quhet Gjetsemani.

-Marku 14, 32. Pastaj vijnë në një vend që quhet Gjetsemani.

Gjykoj.

-Matheu 19, 28. Do të rrini edhe ju mbi dymbëdhjetë frone duke gjykuar të dymbëdhjetë fiset e Izraelit.

-Lluka 6, 37. Edhe mos gjykoni, dhe nuk do të gjykoheni.

-Joani 5, 22. Sepse Ati nuk gjykon asnjë, po gjithë gjyqin ia dha Birit.

-Joani 12, 48. Ka se kush ta gjykojë; fjala që fola, ajo do ta gjykojë në ditën e fundit.

-Veprat e Apostujve 17, 31. Caktoi një ditë, në të cilën do të gjykojë botën me drejtësi.

-Romakëve 2, 1. Cilido që të jesh ti që gjykon, sepse në atë që gjykon tjetrin, dënon veten tënde; sepse ti që gjykon, po ato bën.

-Romakëve 14, 4. Cili je ti që gjykon shërbëtorin e huaj?

-1 Korintasve 6, 2. Anuk e dini se shenjtorët do të gjykojnë botën? Dhe nëse bota do të gjykohet prej jush, a nuk jeni të zotët të gjykoni vogëlsira?

-2 Timotheut 4, 1. Përpara Perëndisë dhe Zotit Jisu Krisht, që ka për të gjykuar të gjallë e të vdekur.

-Hebrenjve 13, 4. Të përdalët dhe kurorëshkelësit do t'i gjykojë Perëndia.

-1 Pjetrit 1, 17. Edhe nëse quani Atë atë që gjykon pa mbajtur anë sipas punës së gjithësecilit.

H

Had.

-Matheu 16, 18. Dyert e hadit nuk do të kenë fuqi përmbi të.

-Matheu 11, 23. Edhe ti, Kapernaum, që je ngritur lart deri në qiell, do të zbresësh deri në had.

-Lluka 10, 15. Edhe ti Kapernaum, që u lartësove deri në qiell, do të zbresësh deri në had.

-Lluka 16, 23. Edhe në hadh, ku ishte në mundime, ngriti sytë e tij e sheh Abrahamin së largu.

-Veprat e Apostujve 2, 31. Shpirti i tij nuk u la në had, as mishi i tij nuk pa prishje.

-Zbulesa 1, 18. Edhe kam çelësat e hadit dhe të vdekjes.

-Zbulesa 6, 8. Hadi vinte prapa bashkë me të.

-Zbulesa 20, 13. Vdekja dhe hadi dhanë të vdekurit që ishin tek ata.

-Zbulesa 20, 14. Edhe vdekja dhe hadi u hodhën në liqenin e zjarrit.

Hardhi.

-Matheu 26, 29. Nuk kam për të pirë që tani e tutje nga kjo pemë, që pjell hardhia.

-Joani 15, 5. Unë jam vreshti, ju jeni hardhitë.

-Zbulesa 14, 18. Dërgo draprin tënd të mprehtë dhe vil rrushin e vreshtit të dheut, sepse u poq rrushi i tij.

Hare.

-Veprat e Apostujve 14, 17. Duke mbushur zemrat tona me ushqim e me gëzim.

Hipokrit.

-Matheu 7, 5. Hipokrit, nxirr më përpara traun nga syri yt.

-Matheu 15, 7. Hipokritë! Mirë profetizoi Isaia për ju.

-Matheu 23, 13. Po mjerë ju shkrues e Farisenj, hipokritë.

-Matheu 24, 51. Do ta vërë pjesën e atij bashkë me hipokritët.

-Lluka 12, 1. Ruani veten tuaj nga brumi i Farisenjve, që është hipokrizi.

-Romakëve 12, 9. Dashuria le të jetë pa hipokrizi.

-2 Korintasve 6, 6. Në Shpirt të Shenjtë, në dashuri johipokrite.

-1 Timotheut 4, 2. Që flasin gënjeshtër me hipokrizi.

-2 Timotheut 1, 5. Sjell ndër mend besimin tënd pa hipokrizi.

I

Idhull.

-Veprat e Apostujve 7, 41. Edhe bënë një viç në ato ditë, dhe i prunë theror idhullit

-1 Korintasve 8, 4. Pra për ngrënien e therorëve që u bëhen idhujve, e dimë se idhulli s'është asgjë në botë.

-2 Korintasve 6, 16. Ose ç'pajtim ka tempulli i Perëndisë me idhujt?

-1 Joanit 5, 21. Bij, ruhuni nga idhujt.

Isaia.

-Matheu 15, 7. Mirë profetizoi Isaia për ju.

-Romakëve 15, 12. Edhe përsëri Isaia thotë: "Do të jetë rrënja e Jeseut".

Iskariot.

-Matheu 10, 4. Simon Kananeasi dhe Juda Iskarioti, i cili edhe e tradhtoi atë.

-Matheu 26, 14. Atëherë një nga të dymbëdhjetët, ai që quhej Juda Iskarioti.

-Joani 6, 71. Edhe thoshte për Juda Iskariotin, të birin e Simonit.

Izrael.

-Joani 1, 48. Shih një Izraelit i vërtetë, tek i cili nuk ka gënjeshtër.

-Veprat e Apostujve 13, 23. Perëndia sipas premtimit të tij, i ngriti Izraelit shpëtimtar Jisuin.

-Romakëve 9, 6. Sepse të gjithë sa janë prej Izraelit, këta nuk janë Izrael.

-Romakëve 11, 1. Sepse edhe unë Izraelit jam.

-Efesianëve 2, 12. Të përjashtuar nga qytetaria e Izraelit.

-Hebrenjve 8, 10. Sepse kjo është dhiata që do të bëj me shtëpinë e Izraelit.

J

Jakov.

-Matheu 4, 21. Pa dy vëllezër të tjerë, Jakovin, të birin e Zevedheut.

-Matheu 10, 3. Jakovi i Alfeut dhe Leveu që u quajt me përmbiemrin Tade.

-Matheu 13, 55. E ëma e tij a nuk quhet Mariam, dhe të vëllezërit e tij Jakov dhe Josi dhe Simon dhe Juda?

-Matheu 22, 32. Unë jam Perëndia i Abrahamit dhe Perëndia i Isakut dhe Perëndia i Jakovit”?”

-Marku 10, 35. Vijnë tek ai Jakovi dhe Joani, të bijtë e Zevedheut.

-Marku 15, 40. E ëma e Jakovit të vogël dhe e Josiut.

-Lluka 6, 14. Andrean, vëllanë e tij, Jakovin dhe Joanin, Filipin e Vartholomeun.

-Lluka 24, 10. Maria e ëma e Jakovit.

-Romakëve 9, 13. Siç është shkruar “Jakovin e desha, po Isafin e pata smirë”.

-1 Korintasve 15, 7. Pastaj iu duk Jakovit, pastaj gjithë apostujve.

-Hebrenjve 11, 9. Bashkë me Isakun e me Jakovin.

Jerusalem.

-Matheu 23, 37. Jerusalem, Jerusalem, që vret profetët, dhe rreh me gurë ata.

-Lluka 21, 24. Jerusalemi do të shkelet prej kombesh.

-Galatasve 4, 26. Po Jerusalemi i sipërm, që është nëna e ne të gjithëve.

-Hebrenjve 12, 22. Në Jerusalemin qiellor, dhe në mori engjëjsh.

-Zbulesa 3, 12. Të Jerusalemit të ri, që zbret prej qiellit nga Perëndia im.

-Zbulesa 21, 2. Jerusalemin e ri, që ishte bërë gati si nuse e stolisur.

Jetë.

-Lluka 16, 25. O djalë, kujtohu, se ti i more të mirat e tua në jetën tënde.

-Joani 3, 16. Po të ketë jetë të përjetshme.

-Joani 5, 26. Sepse sikurse Ati ka jetë në veten e tij, kështu i dha edhe të Birit të ketë jetë në veten e tij.

-Joani 11, 25. Jisui i tha: Unë jam ngjallja dhe jeta.

-Joani 14, 6. Unë jam udha dhe e vërteta dhe jeta.

-Joani 17, 3. Edhe kjo është jeta e përjetshme.

-Veprat e Apostujve 26, 4. Jetën time që prej djalërisë, të cilën e jetova që në fillim.

-Romakëve 6, 23. Dhurata e Perëndisë jetë e përjetshme me anë të Jisu Krishtit, Zotit tonë.

-Zbulesa 20, 10. Dhe do të mundohen ditë e natë, në jetë të jetëve.

-Zbulesa 20, 15. Edhe ai që nuk u gjet i shkruar në librin e jetës.

-Zbulesa 22, 14. Që të kenë pushtet mbi drurin e jetës.

-Zbulesa 22, 17. Dhe ai që do, le të marrë falas ujin e jetës.

Jisu.

-Matheu 1, 21. Edhe do të lindë djalë dhe do t'ia vësh emrin Jisu.

-Matheu 3, 16. Edhe Jisui, si u pagëzua, menjëherë doli nga uji.

-Matheu 27, 17. Barabain apo Jisuin që quhet Krisht.

-Matheu 27, 37. Ky është Jisui, mbreti i Judenjve.

-Lluka 2, 43. Djali Jisu mbeti prapa në Jerusalem; dhe Josifi dhe e ëma nuk e dinë.

-Joani 1, 44. Të nesërmen Jisui deshi të dalë në Galile.

-Joani 17, 3. Të njohin ty të vetmin të vërtetin Perëndi dhe Jisu Krishtin që dërgove.

-Veprat e Apostujve 2, 36. Le ta dijë pra fort mirë gjithë shtëpia e Izraelit se këtë Jisuin, të cilin ju e kryqëzuat.

-Veprat e Apostujve 4, 13. Por i njihnin se kishin qenë bashkë me Jisuin.

-Veprat e Apostujve 9, 5. Unë jam Jisui që ndjek ti.

-Romakëve 6, 23. Dhurata e Perëndisë jetë e përjetshme me anë të Jisu Krishtit, Zotit tonë.

-Hebrenjve 2, 9. Por Jisuin që qe bërë pakgjë më i ulët nga engjëjt e shohim.

-Filipianëve 2, 10. Që në emrin e Jisuit të përkulet çdo gju i atyre që janë në qiejt.

-Zbulesa 1, 5. Nga Jisu Krishti, që është dëshmitari besnik.

-Zbulesa 20, 4. Pashë shpirtrat e atyre që ishin therur për dëshminë e Jisuit.

Jona.

-Matheu 12, 40. Sepse siç ishte Jonai në bark të balenës tri ditë e tri net.

-Lluka 11, 30. Sepse sikurse Jonai u bë shenjë në Ninevitët.

Jopë.

-Veprat e Apostujve 9, 42. Pjetri qëndroi mjaft ditë në Jopë.

Jordan.

-Marku 1, 9. U pagëzua nga Joani në Jordan.

Judenj.

-Matheu 2, 2. Ku është mbreti i Judenjve që ka lindur?

-Matheu 24, 16. Atëherë ata që janë në Jude le të ikin nëpër male.

-Matheu 27, 11. Ti je mbreti i Judenjve?

-Lluka 21, 21. Atëherë ata që të jenë në Jude, le të ikin nëpër male.

-Romakëve 2, 29. Por Judeas është ai që është përbrenda Judeas.

-Romakëve 3, 29. Apo vetëm i Judenjve është Perëndia?

-1 Korintasve 1, 23. Po ne predikojmë Krishtin e kryqëzuar, i cili për Judenjtë është skandal.

-1 Korintasve 9, 20. Edhe u bëra tek Judenjtë si Judeas, që të fitoj Judenjtë.

-Galatasve 3, 38. Nuk ka më Judeas as Grek.

-Zbulesa 3, 9. Që thonë për veten e tyre se janë Judenj.

K

Kain.

-Hebrenjve 11, 4. Abeli i ofroi Perëndisë therore më të mirë se Kaini.

-1 Joanit 3, 12. Jo si Kaini i cili ishte prej të ligut, dhe theri të vëllanë.

Kajafa.

-Joani 11, 49. Edhe një nga ata, Kaiafa, që ishte kryepriфт i atij viti.

-Joani 18, 13. Sepse ishte i vjehrri i Kaiafës, i cili ishte kryepriфт i atij viti.

-Veprat e Apostujve 4, 6. Ana kryepriфтi e Kaiafa e Joani e Aleksandri.

Kanë.

-Joani 2, 1. Edhe të tretën ditë u bë dasmë në Kana të Galileësë.

-Joani 4, 46. Jisui pra erdhi përsëri në Kana të Galileësë.

Kapernaum.

-Matheu 4, 13. Edhe si la Nazaretin, erdhi e ndenji në Kapernaum.

-Matheu 11, 23. Edhe ti, Kapernaum, që je ngritur lart deri në qiell.

-Lluka 4, 23. Sa dëgjuam që janë bërë në Kapernaum.

-Joani 2, 12. Pastaj zbriti në Kapernaum, ai dhe e ëma e të vëllezërit.

-Joani 6, 59. Këto tha në sinagogë duke mësuar në Kapernaum.

Kishë.

-Veprat e Apostujve 16, 5. Kishat pra forcoheshin në besim e përditë shtoheshin nga numri.

-Veprat e Apostujve 20, 28. Kullotni kishën e Perëndisë, të cilën e fitoi me gjakun e tij.

-1 Korintasve 14, 34. Si në të gjitha kishat e shenjtorëve, gratë tuaja le të heshtin në kishë.

-Efesianëve 1, 22. Vuri krye përmbi të gjitha në kishë.

-Efesianëve 5, 24. Po siç i bindet kisha Krishtit, kështu edhe gratë le t'u binden burrave të tyre.

-Galatasve 1, 13. Përndiqja kishën e Perëndisë.

-Hebrenjve 12, 23. Në kishën e të parë lindurve, të cilët janë shkruar në qiejt.

Kornil.

-Veprat e Apostujve 10, 1. Edhe ishte një njeri në Qesari që quhej Kornil.

-Veprat e Apostujve 10, 3. Një engjëll të Perëndisë që hyri tek ai, e i tha: Kornil.

-Veprat e Apostujve 10, 22. Edhe ata thanë: Kornili, kryeqindëshi, që është njeri i drejtë.

-Veprat e Apostujve 10, 25. Edhe sapo hyri brenda Pjetri, Kornili i doli përpara.

-Veprat e Apostujve 10, 30. Edhe Kornili tha: Katër ditë më parë deri në këtë orë.

Krisht.

-Matheu 16, 16. Ti je Krishti, i biri i Perëndisë së gjallë.

-Joani 17, 3. Perëndinë e vetëm të vërtetë dhe Jezus Krishtin, të cilin ke dërguar.

-Romakëve 8, 17. Ti je Krishti, i biri i Perëndisë së gjallë.

-1 Korintasve 1, 13. A është i ndarë Krishti?

-1 Korintasve 3, 23. Ju jeni të Krishtit dhe Krishti është i Perëndisë.

-1 Korintasve 7, 22. Ai që u thirr kur ishte i lirë, është skllav i Krishtit.

-1 Korintasve 12, 12. Bëjnë një trup, kështu edhe Krishti.

-1 Korintasve 15, 23. Krishti është pema e parë, pastaj sa janë të Krishtit.

-2 Korintasve 12, 10. Në përndjekjet, në ankthet, për hir të Krishtit.

-Galatasve 3, 29. Po t'i përkisni Krishtit, atëherë jeni pasardhës të Abrahamit.

-Efesianëve 5, 23. Sepse burri është koka e gruas, ashtu siç është Krishti koka e kishës.

-Filipianëve 2, 11. Të rrëfejë se Jisu Krishti është Zot, për lavdi të Perëndisë Atë.

-Kolosianëve 1, 24. Tani gëzohem me vuajtjet e mia për ju dhe i plotësoj në mishin tim ato që u mungojnë vuajtjeve të Krishtit.

-Kolosianëve 1, 27. Që është Krishti në ju, shpresa e lavdisë.

-1 Pjetrit 2, 21. Për këtë jeni thirrur, sepse edhe Krishti vuajti për ju.

-1 Pjetrit 4, 13. Por gëzohuni që merrni pjesë në vuajtjet e Krishtit.

Kryebari.

-1 Pjetrit 5, 4. Kur të shfaqet Kryebari, ju do të merrni kurorën e lavdisë që nuk fishket kurrë.

Kryepriift.

-Hebrenjve 3, 1. Mbajeni mendjen tek Jezusi, Apostulli dhe Kryepriifti i besimit tonë.

-Hebrenjve 5, 5. Kështu edhe Krishti nuk i dha lavdi Vetes që të bëhej kryepriift.

-Hebrenjve 6, 20. Duke u bërë kryepriift përjetë në rendin e Melkizedekut.

-Hebrenjve 9, 25. Siç hyn kryepriifti në Vendin më të Shenjtë çdo vit me gjakun që nuk është i tiji.

Kupë.

-Matheu 10, 42. Dhe kushdo që do t'i japë për të pirë njërit prej këtyre të vegjëlve vetëm një kupë ujë të ftohtë.

-Lluka 22, 20. Po ashtu, pas darkës mori edhe kupën dhe tha:

-Lluka 22, 42. O Atë, po të duash, largoje këtë kupë prej Meje.

-1 Korintasve 10, 21. Nuk mund të pini edhe kupën e Zotit edhe kupën e demonëve.

-Zbulesa 16, 1. Shkoni dhe derdhini mbi tokë të shtatë kupat e zemërimit të Perëndisë.

-Zbulesa 17, 1. Një nga të shtatë engjëjt që kishin të shtatë kupat erdhi dhe më tha.

Kurorë.

-Matheu 27, 29. Thurën një kurorë me gjemba dhe ia vunë mbi kokë.

-1 Selanikasve 2, 19. Sepse, cila është shpresa jonë, gëzimi ynë apo kurora e lëvdimit tonë përpara Zotit.

-2 Timotheut 4, 8. Pas kësaj më pret kurora e drejtësisë, të cilën do të ma japë Zoti.

-Jakovi 1, 12. Lum ai njeri që këmbëngul në sprovë, sepse sapo t'i kapërcejë ato, do të marrë kurorën e jetës.

-1 Pjetrit 5, 4. Kur të shfaqet Kryebariu, ju do të merrni

kurorën e lavdisë që nuk fishket kurrë.

-Zbulesa 2, 10. Qëndro besnik deri në vdekje dhe do të të jap kurorën e jetës.

Kurorëshkelje.

-Matheu 5, 28. Ka shkelur tashmë kurorën me të në zemrën e vet.

-Marku 7, 22. Tradhtitë bashkëshortore, pangopësitë, ligësitë, mashtrimi, epshi, syri i lig.

-Romakëve 3, 7. Ajo bashkohet me një burrë tjetër, do të quhet shkelëse kurore.

-1 Korintasve 6, 9. As shkelësit e kurorës, as burrat si femra, as ata që shkojnë me burra.

-Jakovi 2, 11. Sepse Ai që tha: “Mos shkel kurorën”, ka thënë edhe: “Mos vra”. Nëse nuk shkel kurorën, por vret, je bërë shkelës i ligjit.

-Jakovi, 4, 4. Ju, o njerëz që shkelni kurorën, a nuk e dini

se miqësia me botën është
armiqësi me Perëndinë?

-Hebrenjve 13, 4. Perëndia do
t'i gjykojë të përdalët dhe
shkelësit e kurorës.

-Zbulesa 2, 22. Ata që bëjnë
tradhti bashkëshortore me të,
do t'i bëj të vuajnë.

L

Lajm i mirë.

-Matheu 9, 35. Duke
predikuar lajmin e mirë të
mbretërisë dhe duke shëruar
çdo sëmundje e çdo lëngatë.

-Lluka 2, 10. Engjëlli u tha:
“Mos kini frikë, sepse, ja, po
ju sjell lajmin e mirë
gëzimplotë.

Lakmi.

-Marku 7, 22. Vjedhje,
lakmira, ligësira, mashtrim,
shthurje, shikim me sy të keq.

-Lluka 12, 15. Vështroni e
ruhuni nga lakmia.

-Romakëve 1, 29. Me çdo lloj
paudhësie, përdaljeje,
dinakërie, lakmie, ligësie.

-Romakëve 7, 7. Po të mos
thoshte ligji “Mos lakmo”.

-1 Korintasve 5, 11. Në qoftë
se është i përdalë, ose lakmitar,
ose idhujtar.

-Efesianëve 5, 3. Po për imoralitet e çdo ndyrësi, ose lakmi.

-Kolosianëve 3, 5. Imoralitetin, ndyrësinë morale, epshin, lakminë e keqe.

-1 Selanikasve 2, 5. Sepse as fjalë me lajka nuk përdorëm ndonjëherë, siç e dini, as shkak lakmie.

-2 Pjetrit 2, 3. Edhe për lakmi do t'ju tregtojnë me fjalë gënjeshtare.

Lavdi.

-Matheu 5, 16. E të lavdërojnë Atin tuaj që është në qiejt.

-Matheu 21, 16. Se nga goja e fëmijëve dhe e foshnjave bëre gati lavdërim”?

-Matheu 25, 31. Edhe kur të vijë Biri i njeriut në lavdinë e tij.

-Lluka 2, 14. Lavdi Perëndisë që është në të lartat, edhe paqe.

-Joani 15, 8. Im Atë në këtë lavdërohet, të sillni shumë pemë.

-Joani 17, 1. Atë, erdhi ora, lavdëro Birin tënd, që të të lavdërojë edhe yt Bir.

-Joani 17, 5. Edhe tani lavdëromë ti, o Atë, pranë teje, me lavdinë që pata pranë teje.

-Romakëve 1, 21. Sepse, ndonëse e njohën Perëndinë, nuk e lavdëruan si Perëndi.

-Romakëve 8, 17. Që edhe të lavdërohemi bashkë me atë.

-Romakëve 9, 23. Edhe që të bëjë të njohur pasurinë e lavdisë së tij.

-1 Korintasve 6, 20. Lavdëroni pra Perëndinë me trupin tuaj.

-2 Korintasve 3, 8. Më shumë e lavdishme shërbesa e Shpirtit?

-Hebrenjve 5, 5. Kështu edhe Krishti nuk e lavdëroi veten e tij.

-Zbulesa 18, 7. Sa lavdëroi vetveten dhe u kënaq në epshet.

-Zbulesa 21, 23. Sepse lavdia e Perëndisë e ndriçoi atë.

Lind.

-Matheu 1, 6-16. Abrahamit i lindi Isaku. Jakovit i lindi Josifi, burri i Marisë, prej së cilës lindi Jisui.

-Lluka 2, 11. Sepse sot ju lindi juve në qytetin e Davidit një shpëtimtar.

-Joani 3, 3. Nëse nuk lind njeriu prej së larti.

-Joani 16, 21. Gruaja, kur lind, ka hidhërim, se i erdhi ora; por si të lindë foshnjen.

-1 Timotheut 2, 15. Do të shpëtojë me anë të lindjes së fëmijëve.

-1 Pjetrit 1, 3. Na lindi përsëri në një shpresë të gjallë.

-Zbulesa 12, 2. Bërtiste nga dhimbjet e barkut, dhe mudohej për të lindur.

Liri.

-Romakëve 8, 21. Të shkojë në lirinë e lavdisë së bijve të Perëndisë.

-1 Korintasve 10, 29. Përse të gjykohet liria ime prej ndërgjegjes së tjetrit?

-2 Korintasve 3, 17. Dhe Zoti është Shpirti; dhe ku është Shpirti i Zotit, atje ka liri.

-Galatasve 2, 4. Për të përgjuar lirinë tonë që kemi në Jisu Krishtin, që të na robërojnë.

-Galatasve 5, 1. Qëndroni pranë lirinë, me të cilën na çliroi Krishti.

-Galatasve 5, 13. Sepse ju, vëllezër, u thirrët në liri; vetëm mos e përdorni lirinë për shkak të mishit.

-Jakovit 1, 25. Po ai që ulet e shikon në ligjin e përsosur të lirisë.

-1 Pjetrit 2, 16. Si të lirë, e jo si njerëz që kanë lirinë për mbulesë të ligësisë.

-2 Pjetrit 2, 19. Duke u premtuar atyre liri, ndërsa ata vetë janë robër të prishjes;

Lutje.

-Matheu 21, 13. “Shtëpia ime do të quhet shtëpi lutjeje”; por ju e bëtë atë “shpellë kusarësh”.

-Marku 12, 40. Këtë e bëjnë duke nxjerrë shkak se falen shumë;

-Veprat e Apostujve 10, 4. Faljet e tua dhe lëmoshat e tua u ngjiten për kujtim përpara Perëndisë.

-Romakëve 12, 12. Në shpresë të gëzoheni; në shtrëngim të duroni; në falje të qëndroni;

-Filipianëve 4, 6. Kërkesat tuaja le t’i bëhen të njohura

Perëndisë me falënderime me anë të faljes e të lutjes.

-Kolosianëve 4, 2. Qëndroni në falje, duke ndenjur zgjuar në të me falënderime;

-1 Pjetrit 4, 7. Edhe fundi i të gjithave u afrua; urtësohuni pra, e rrini zgjuar në falje.

-Zbulesa 8, 3. Bashkë me faljet e gjithë shenjtoreve mbi altarin e artë që është përpara fronit.

LL

Llambë.

-Matheu 25, 1. Mbretëria e qiejve do të ngjajë me dhjetë virgjëresha, të cilat morën llambat e tyre.

Llazar.

-Lluka 16, 20. Ishte dhe një i varfër që e kishte emrin Llazar.

-Joani 11, 1. Edhe ishte një njeri i sëmurë, që quhej Llazar, nga Betania.

-Joani 11, 2. Vëllai i së cilës, Llazari, ishte sëmurë.

-Joani 12, 1. Jisui pra gjashtë ditë përpara pashkës erdhi në Betani, ku ishte Llazari që pati vdekur.

-Joani 12, 2. Marta shërbente; dhe Llazari ishte një prej atyre që rrinin në tryezë bashkë me të.

Llogari.

-Romakëve 14, 12. Kështu pra, gjithësecili prej nesh do t'i japë llogari Perëndisë për veten e vet.

-Hebrenjve 4, 13. Në sytë e atij, të cilit ne kemi për t'i dhënë llogari.

Lluka.

-Kolosianëve 4, 14. Ju përshëndet Llukai, mjeku i dashur, edhe Dhimai.

-2 Timotheut 4, 11. Vetëm Llukai është bashkë me mua.

M

Maja.

-Matheu 13, 33. Mbretëria e qiejve ngjan me brumin, të cilin e mori një grua.

-Matheu 16, 6. Shikoni e ruhuni me kujdes nga brumi i Farisenjve e i Saduqenjve.

-Matheu 16, 12. Atëherë e kuptuan, se nuk u tha të ruhen nga brumi i bukës.

-Marku 8, 15. Shikoni, ruhuni nga brumi i Farisenjve.

-Lluka 12, 1. Së pari, ruani veten tuaj nga brumi i Farisenjve, që është hipokrizi.

-Lluka 13, 21. Përngjan me brumë, të cilin e mori një grua dhe e fshehu në tri masa mielli.

-1 Korintasve 5, 7. Pastrohuni pra nga brumi i vjetër, që të jeni brumë i ri, siç jeni pa brume.

-Galatasve 5, 9. Pakëz brumë mbrun gjithë mbrujtjen.

Mal.

-Matheu 4, 8. Përsëri djalli e merr me vete mbi një mal shumë të lartë.

-Matheu 17, 20. Në paçi besim sa një kokërr sinapi, do t'i thoni këtij mali:

-Marku 13, 14. Ata që të jenë në Jude, le të ikin nëpër male.

-Lluka 3, 5. Çdo vend i thellë do të mbushet, dhe çdo mal e kodër do të ulet.

-Lluka 22, 39. Pastaj doli e shkoi, siç e kishte zakon në Malin e Ullinjve;

-Veprat e Apostujve 1, 12. Atëherë u kthyen në Jerusalem nga mali që quhet Ullishte.

-Veprat e Apostujve 7, 30. Iu shfaq atij në shkretëtirën e malit Sinai.

-Hebrenjve 12, 22. Por u afruat në malin Sion, dhe në qytetin e Perëndisë së gjallë.

-Zbulesa 6, 16. Edhe u thonë maleve e shkëmbinjve:

-Zbulesa 14, 1. Edhe pashë, dhe ja një Qengj tek rrinte mbi malin Sion.

Mallkim.

-Joani 7, 49. Po kjo turmë që s' di ligjin, janë të mallkuar.

-Romakëve 12, 14. Bekoni ata që ju përndjekin; beconi e mos mallkoni.

-1 Korintasve 12, 3. Askush që flet me Shpirt Perëndie nuk thotë për Jisuin, qoftë i mallkuar;

-1 Korintasve 16, 22. Nëse ndonjë nuk e do Zotin Jisu Krisht, qoftë i mallkuar.

-Galatasve 1, 8. Predikoftë tjetër ungjill e jo atë që ju predikuam, qoftë i mallkuar.

-Galatasve 3, 13. Krishti na shpërbleu nga mallkimi i ligjit, sepse u bë mallkim për ne;

-Zbulesa 22, 3. Edhe asnjë mallkim nuk do të ketë më;

Maqedoni.

-Veprat e Apostujve 16, 9. Shko në Maqedoni, e ndihmona.

-Veprat e Apostujve 20, 1. U përshëndet me ta, dhe doli të shkojë në Maqedoni.

-1 Korintasve 16, 5. Edhe do të vij tek ju, kur të kaloj nëpër Maqedoni.

-2 Korintasve 8, 1. Hirin që u është dhënë nga Perëndia kishave të Maqedonisë;

-1 Selanikasve 1, 7. U bëtë shembull për të gjithë besimtarët në Maqedoni.

-1 Selanikasve 4, 10. Gjithë vëllezërit që janë në gjithë Maqedoninë.

Margaritar.

-Matheu 7, 6. As mos hidhni margaritarët tuaj përpara derrave.

-Matheu 13, 45. Mbretëria e qiejve ngjan me një njeri

tregtar, që kërkonte margaritarë të mirë.

-Matheu 13, 46. Kur gjeti një margaritar shumë të vlefshëm.

-Zbulesa 17, 4. Me ar e me gurë të çmuar e me margaritarë.

-Zbulesa 18, 12. Mall ari e argjendi, dhe gurësh të çmuar, dhe margaritarësh.

-Zbulesa 21, 21. Edhe të dymbëdhjetë portat ishin dymbëdhjetë margaritarë.

Maria.

-Matheu 1, 16. Edhe Jakovit i lindi Josifi, burri i Marisë.

-Matheu 13, 55. E ëma e tij a nuk quhet Mariam.

-Matheu 27, 56. Në mes tyre ishte Maria Magdalena, dhe Maria, e ëma e Jakovit.

-Marku 6, 3. A nuk është ky mjeshtri, i biri i Marisë.

-Marku 15, 47. Edhe Maria Magdalena, edhe Maria, e ëma e Josiut.

-Marku 16, 1. Edhe si shkoi e shtuna, Maria Magdalena, dhe Maria, e ëma e Jakovit.

-Lluka 1, 27. Emri i virgjëreshës ishte Mariam.

-Lluka 2, 19. Mariami i ruante në vete gjithë këto fjalë.

-Lluka 2, 34. Edhe Simeoni i bekoi ata, dhe i tha Mariamit.

-Lluka 8, 2. Maria, që quhej Magdalena, prej së cilës patën dalë shtatë djaj.

-Lluka 10, 39. Edhe ajo kishte një motër që quhej Maria.

-Lluka 10, 42. Maria zgjodhi pjesën e mirë, e cila nuk do të merret prej saj.

-Lluka 24, 10. Edhe ishin Maria Magdalena, dhe Joana, dhe Maria e ëma e Jakovit.

-Joani 19, 25. Maria, gruaja e Klopait, dhe Maria Magdalena.

-Joani 11, 1. Llazar, nga Betania, nga fshati i Marisë e i Martës, motrës së saj.

-Joani 12, 3. Atëherë Maria mori një litër vaj ere prej nardi të papërzier.

-Joani 20, 1. Edhe ditën e parë të javës vjen Maria Magdalena.

-Veprat e Apostujve 12, 12. Erdhi në shtëpinë e Marisë, të ëmës së Joanit.

-Romakëve 16, 6. Përshëndetni Mariamin, e cila u mundua shumë për ne.

Marta.

-Lluka 10, 41. Marta, Marta, përpiqesh e mendolesh për shumë punë.

-Joani 11, 39. Jisui thotë: Ngrini gurin. Marta, e motra e të vdekurit.

-Joani 12, 2. Edhe i bënë darkë atje; dhe Marta shërbente;

Martesë.

-Matheu 22, 30. Sepse në ngjallje as martohen, as martojnë, por janë si engjëj.

-Matheu 24, 38. Përpara përmbytjes, që hanin e pinin, martoreshin e martonin.

-Lluka 14, 20. Edhe një tjetër tha: Mora grua dhe prandaj nuk mund të vij.

-Lluka 17, 27. Hanin, pinin, martonin, martoreshin.

-Lluka 20, 35. Ngjalljen prej së vdekurish as martojnë as martohen.

-Romakëve 7, 2. Sepse gruaja e martuar është e lidhur nga ligji me burrin.

1 Korintasve 7, 9. Edhe po të mos përmbahen dot, le të martohen; sepse është më mirë të martohet njeriu se të digjet.

-1 Korintasve 7, 33. Ndërsa i martuari ka kujdes për punët e botës.

-1 Korintasve 7, 36. Le të bëjë ç' të dojë; nuk mëkaton; le të martohet.

-1 Korintasve 7, 38. Ai që martohet me virgjëreshën, mirë bën; edhe ai që s' martohet, bën më mirë.

-1 Korintasve 7, 39. Po në i vdektë burri, është e lirë të martohet me cilin të dojë.

-1 Timotheut 4, 3. Të cilët ndalojnë martesën dhe urdhërojnë të largohen besimtarët.

-1 Timotheut 5, 14. Dua pra që të rehat të martohen, të bëjnë fëmijë, të bëhen zonja.

-Hebrenjve 13, 4. Martesa le të jetë e ndershme për të gjithë, dhe shtrati i paturpëruar.

-Zbulesa 19, 9. Lum ata që janë ftuar në dasmën e Qengjit.

Mbret.

-Matheu 21, 5. Ja mbreti yt tek po të vjen i butë dhe hipur mbi gomare.

-Matheu 27, 37. Ky është Jisui, mbreti i Judenjve.

-Lluka 21, 12. Përpara mbretërve e qeveritarëve për shkak të emrit tim.

-Joani 18, 37. Pilati pra i tha: Mbret je ti, pra? Jisui u përgjigj: Ti po thua se unë jam mbret.

-Joani 19, 15. Mbretin tuaj të kryqëzoj? Kryepiftërinjtë u përgjigjën: S' kemi tjetër mbret veç Qezarit.

-1 Timotheut 1, 17. Edhe mbretit të jetëve, të pavdekshmit, të padukshmit.

-Zbulesa 16, 14. Të cilat shkojnë tek mbretërit e gjithë botës.

-Zbulesa 19, 16. Mbret i mbretërve dhe Zot i zotërve.

Mëkat.

-Matheu 13, 41. Gjithë skandalet dhe ata që punojnë paudhësinë.

-Matheu 26, 28. Që derdhet për shumë veta për ndjesën e mëkateve.

-Marku 3, 29. Njerëzve do t'u ndjehen gjithë mëkatet.

-Joani 1, 29. Ja Qengji i Perëndisë, që ngre mëkatin e botës.

-Veprat e Apostujve 3, 19. Pendohuni pra dhe kthehuni, që të shuhet mëkatet tuaja.

-Romakëve 4, 8. Lum ai njeri, të cilit Zoti nuk do t'i llogarisë mëkatet.

-Romakëve 5, 12. Me anë të një njeriu hyri mëkati në botë, dhe me anë të mëkatit vdekja.

-Romakëve 5, 21. Siç mbretëroi mëkati me anë të vdekjes.

-Romakëve 6, 23. Sepse paga e mëkatit është vdekje.

-Romakëve 7, 7. Ç'të themi pra? Ligji është mëkat? Qoftë larg. Por mëkatin nuk e njoha.

-Romakëve 8, 2. Më çliroi prej ligjit të mëkatit dhe prej vdekjes.

-Romakëve 14, 23. Çdo gjë që nuk bëhet nga besimi, është mëkat.

-2 Korintasve 5, 21. Sepse Perëndia atë që nuk njohu mëkat për ne e bëri mëkat.

-Hebrenjve 10, 12. Po ai, pasi ofroi një theror për mëkate.

-Hebrenjve 10, 17. Shtoi: dhe mëkatet e tyre dhe paudhësitë e tyre.

-Hebrenjve 10, 26. Nuk mbetet më theror për mëkate.

-Hebrenjve 12, 1. Le të hedhim tej çdo barrë dhe mëkatin që na pushton.

-Jakovit 1, 15. Pastaj dëshirimi, si të mbarset, lind mëkat, dhe mëkati, si të bëhet, lind vdekje.

-Jakovit 4, 17. Ai pra, që di të bëjë mirë, dhe nuk bën, për atë ky është mëkat.

-Jakovit 5, 15. Zoti do ta ngrerë atë; dhe në pastë bërë mëkate, do t'i falen.

-Zbulesa 18, 4. Që të mos keni pjesë në mëkatet e saj.

Miro.

-Matheu 2, 11. Si hapën thesaret e tyre, i prunë atij dhurata, ar e temjan e miro.

-Joani 19, 39. Pruri një përzierje mirre dhe aloe, rreth njëqind litra.

-2 Korintasve 1, 21. Edhe ai që na forcon ne bashkë me ju në Krishtin, e që na leu me vaj, është Perëndia.

-Hebrenjve 1, 9. Prandaj të leu, o Perëndi, Perëndia yt, me vaj gëzimi.

-1 Joanit 2, 20. Edhe ju keni lysterje prej Shenjtit, dhe i dini të gjitha.

Moisi.

-Matheu 17, 3. Edhe ja tek iu dukën atyre Moisiu dhe Ilia.

-Veprat e Apostujve 2, 33. Sepse Moisiu u tha etërve.

-Veprat e Apostujve 7, 22. Edhe Moisiu u mësua në gjithë dituritë e Egjiptianëve.

-1 Korintasve 10, 2. Edhe të gjithë u pagëzuan në Moisiun në re e në det.

-Hebrenjve 3, 2. Sikurse dhe Moisiu qe besnik në gjithë shtëpinë e tij.

-Hebrenjve 11, 24. Me anë të besimit Moisiu, si u bë i madh.

-Zbulesa 15, 3. Këndonin këngën e Moisiut, shërbëtorit të Perëndisë.

Monedhë.

-Matheu 25, 18. Shkoi e gërmoi në dhe, edhe fshehu argjendin e të zotit.

-Matheu 26, 16. Edhe ata i dhanë tridhjetë monedha argjendi.

-Marku 6, 8. Veçse vetëm një shkop; as trastë, as bukë, as bakër në brez.

-Marku 14, 11. Edhe ata kur dëgjuan, u gëzuan; dhe iu zotuan t'i japin argjende.

Murtajë.

-Lluka 21, 11. Tërmete të mëdha në vende të ndryshme, dhe zira e murtaja.

-Veprat e Apostujve 24, 5. Pasi e gjetëm këtë njeri se është murtajë.

N

Nathaniel.

-Joani 1, 46. Filipi gjen Nathanailin.

-Joani 1, 47. Edhe Nathanaili i tha.

-Joani 1, 48. Jisui pa Nathanailin duke ardhur tek ai.

-Joani 1, 49. Nathanaili i thotë: Që ku më njeh?

-Joani 21, 2. Nathanaili që është nga Kana e Galilesë.

Nazaretas.

-Matheu 2, 23. Nazaretas do të quhet.

-Veprat e Apostujve 2, 22. Jisu Nazaretasin, njeri të treguar tek ju nga Perëndia.

-Veprat e Apostujve 24, 5. Është i pari i sektit të Nazaretasit.

-Joani 19, 19. Jisu Nazaretasi mbreti i Judenjve.

Nazaret.

-Matheu 2, 23. Erdhi e ndenji në një qytet që quhet Nazaret;

-Matheu 4, 13. Edhe si la Nazaretin, erdhi e ndenji në Kapernaum.

-Matheu 21, 11. Ky është Jisui, profeti, që është nga Nazareti i Galilesë.

-Joani 1, 46. A mund të dalë ndonjë gjë e mirë nga Nazareti?

Nevojë.

-Matheu 6, 32. Ati juaj qiellori e di se keni nevojë për gjithë këto.

-1 Korintasve 7, 26. Pandeh pra se kjo është e mirë për nevojën e tanishme.

-1 Korintasve 9, 16. Kjo është një nevojë e madhe për mua;

-1 Korintasve 12, 22. Këto janë shumë më tepër të nevojshme.

Nënë.

-Lluka 8, 21. Nënë e vëllezër më janë këta që dëgjojnë fjalën.

-Lluka 12, 53. E ëma kundër së bijës, dhe e bija kundër së ëmës.

-Lluka 14, 26. Në ardhhtë ndonjë tek unë dhe nuk mërzit të atin e të ëmën.

-Galatasve 4, 26. Po Jerusalemi i sipërm, që është nëna e ne të gjithëve.

Ngjallëm.

-1 Korintasve 15, 22. Të gjithë do të marrin jetë në Krishtin.

-1 Pjetrit 3, 18. Por duke u ngjallur me anë të Shpirtit;

Nikodhim.

-Joani 3, 1. Edhe ishte një njeri nga Farisenjtë, që e kishte emrin Nikodhim.

-Joani 3, 4. Nikodhimi i thotë: Si mund të lindet njeriu duke qenë plak?

-Joani 3, 9. Nikodhimi u përgjigj e i tha: Si mund të bëhen këto?

-Joani 7, 50. U thotë atyre Nikodhimi, ai që pati ardhur natën tek ai.

-Joani 19, 39. Erdhi edhe Nikodhimi, ai që pati ardhur te Jisui.

Nxjerr.

-Galatasve 4, 15. Po kur i pëlqeu Perëndisë, i cili më ndau që nga barku i nënës.

NJ

Njeri.

-Matheu 4, 4. Njeriu nuk do të rrojë vetëm me bukë, po me çdo lloj fjale.

-Matheu 4, 19. Ejani pas meje, dhe do t'ju bëj peshkatarë njerëzish.

-Matheu 15, 9. Duke mësuar mësimet që janë porosi njerëzish.

-Lluka 16, 15. Që nxirrni veten tuaj të drejtë përpara njerëzve.

-Veprat e Apostujve 5, 29. Duhet t'i bindemi Perëndisë më tepër se njerëzve.

-Romakëve 5, 12. Prandaj sikurse me anë të një njeriu hyri mëkati në botë.

-Romakëve 7, 22. Sipas njeriut të brendshëm gjen shkrim në ligjin e Perëndisë.

-1 Korintasve 15, 47. Njeriu i parë është prej dheu, prej balte; njeriu i dytë është Zoti.

-2 Korintasve 4, 16. Ndonëse njeriu ynë i jashtëm prishet, i brendshmi përtërihet.

-Galatasve 1, 10. Sepse tani, po bind njerëzit, apo Perëndinë?

-Efesianëve 3, 16. Me anë të Shpirtit të tij në njeriun e brendshëm;

-Efesianëve 4, 13. Të njohjes së Birit të Perëndisë, në njeri të përsosur.

-1 Pjetrit 3, 4. Njeriu i fshehtë i zemrës, stolitur me paprishjen e shpirtit të butë.

Njoh.

-Matheu 7, 20. Prandaj nga pemët e tyre do t'i njihni ata.

-Joani 8, 32. Do të njihni të vërtetën, dhe e vërteta do t'ju çlirojë ju.

-Joani 10, 14. Unë jam bariu i mirë, dhe njoh të miat, dhe njihem prej të miave.

-Joani 10, 15. Siç më njeh Ati edhe unë e njoh Atin;

-2 Korintasve 6, 9. Si të panjohur, po të njohur mire.

-Galatasve 1, 22. Nuk isha i njohur personalisht në kishat e Judesë në Krishtin.

Njollë.

-Efesianëve 5, 27. Kishë të lavdishme, pa pasur njollë.

-2 Pjetrit 2, 20. Me anë të njohjes së Zotit dhe Shpëtimtarit Jisu Krisht.

O

Omega.

-Zbulesa 1, 8. Unë jam Alfa dhe Omega, fillimi dhe mbarimi.

-Zbulesa 21, 6. Unë jam Alfa dhe Omega, fillimi dhe mbarimi.

-Zbulesa 22, 13. Unë jam Alfa dhe Omega, fillimi dhe mbarimi, i pari dhe i fundit.

Orë.

-Matheu 24, 36. Edhe për atë ditë e për atë orë, asnjë nuk di gjë, as engjëjt e qiejve.

-Matheu 24, 44. Biri i njeriut vjen në atë orë që nuk jua pret mendja juve.

-Matheu 24, 50. Do të vijë në atë ditë që ai nuk e pret dhe në atë orë që nuk e di;

-Matheu 26, 45. Ja tek u afrua ora, dhe Biri i njeriut jepet në duar fajtorësh.

-Lluka 22, 53. Po kjo është ora juaj dhe pushteti i errësirës.

-Joani 17, 1. Atë, erdhi ora, lavdëro Birin tënd.

-1 Joanit 2, 18. Fëmijë, është ora e fundit; dhe siç dëgjuat se antikrishti vjen.

-Zbulesa 3, 10. Unë do të të ruaj ty nga ora e ngasjes.

-Zbulesa 14, 7. Sepse erdhi ora e gjyqit të tij;

-Zbulesa 14, 15. Sepse erdhi ora të korrësh.

-Zbulesa 18, 10. Sepse për një orë erdhi gjyqi yt.

P

Padrejtësi.

-Romakëve 9, 14. Mos ka padrejtësi tek Perëndia?

-1 Korintasve 6, 7. Përse më mirë nuk lejoni t'ju bëhet juve padrejtësi?

-1 Joanit 5, 17. Çdo padrejtësi është mëkat; dhe ka mëkat jo për vdekje.

Pafaj.

-Matheu 27, 24. I pafajshëm jam nga gjaku i këtij të drejti.

Pagëzim.

-Matheu 3, 11. Unë ju pagëzoj me ujë për pendim.

-Matheu 3, 13. Jisui vjen nga Galilea në Jordan tek Joani, që të pagëzohet prej tij.

-Marku 1, 8. Unë ju pagëzova me ujë, po ai do t'ju pagëzojë me Shpirt të Shenjtë.

-Marku 10, 38. Të pagëzoheni me pagëzimin që pagëzohem unë?

-Lluka 3, 3. Duke predikuar pagëzim pendimi për ndjesën e mëkateve.

-Lluka 3, 16. Unë ju pagëzoj me ujë; por vjen më i forti se unë.

-Lluka 12, 50. Edhe kam një pagëzim me të cilin do të pagëzohem.

-Joani 1, 26. Unë pagëzoj me ujë; por në mes tuaj rri ai që ju nuk e njihni.

-Veprat e Apostujve 2, 41. Ata pra që pritën me gëzim fjalën e tij u pagëzuan;

-Veprat e Apostujve 10, 47. A mos mundet uji të ndalojë ndonjë që të mos pagëzohen këta.

-Veprat e Apostujve 19, 4. Joani pagëzoi pagëzim pendimi, duke i thënë popullit.

-Romakëve 6, 3. Në Jisu Krishtin, në vdekjen e tij u pagëzuan?

-Romakëve 6, 4. U varrosëm pra, bashkë me të me anë të pagëzimit në vdekjen.

-1 Korintasve 10, 2. Edhe të gjithë u pagëzuan në Moisiun në re e në det.

-1 Korintasve 12, 3. Sepse ne të gjithë jemi pagëzuar me anë të po atij Shpirti në një trup.

-1 Korintasve 15, 29. Sepse ç' do të bëjnë ata që pagëzohen për të vdekurit.

-Efesianëve 4, 5. Një Zot, një besim, një pagëzim.

-Kolosianëve 2, 12. Duke u varrosur bashkë me atë në pagëzim.

-1 Pjetrit 3, 21. Pagëzimi, na shpëton edhe ne.

Pagëzori.

-Matheu 3, 1. Edhe në ato ditë vjen Joan Pagëzori duke predikuar.

-Matheu 11, 11. Nuk është ngritur ndonjë më i madh se Joan Pagëzori.

-Matheu 14, 2. Edhe u tha shërbëtorëve të tij: Ky është Joan Pagëzori.

-Lluka 7, 33. Sepse erdhi Joan Pagëzori, që as bukë ha, as verë pi, dhe thoni:

Pajtim.

-Matheu 5, 24. Shko e pajtohu më parë me tët vëlla.

-Romakëve 5, 10. Sepse, në qoftë se kur ishim armiq u pajtuam me Perëndinë.

-Romakëve 5, 11. Me anë të Zotit tonë Jisu Krisht, me anë të të cilit morëm tani pajtimin.

-2 Korintasve 5, 18. Edhe të gjitha janë prej Perëndisë, që na pajtoi me veten e tij.

-Efesianëve 2, 16. Të dy në një trup t'i pajtojë me Perëndinë me anë të kryqit.

Paqe.

-Matheu 10, 34. Mos pandehni se kam ardhur të vë paqe mbi dhe.

-Lluka 2, 14. Lavdi Perëndisë që është në të lartat, edhe paqe mbi dhe.

-Joani 14, 27. Paqe po ju lë, paqen time po ju jap juve;

-Romakëve 14, 19. Kështu pra, le të ndjekim ato që i shërbejnë paqes.

-Romakëve 16, 20. Edhe Perëndia i paqes do të dërrmojë satanain në këmbët tuaja.

-2 Korintasve 13, 11. Pra, vëllezër, gëzohuni, ngushëllohuni, jini në një mendje, kini paqe.

-Efesianëve 6, 15. Me gatishmërinë për ungjillin e paqes.

-Filipianëve 4, 7. Edhe paqja e Perëndisë që kapërcen çdo mendje.

-1 Selanikasve 5, 3. Paqe dhe siguri, atëherë vjen mbi ata humbje e papandehur.

-Hebrenjve 12, 11. U jep pemë paqeje prej drejtësie.

-1 Pjetrit 3, 11. Le të kërkojë paqe, dhe le ta ndjekë atë.

-Zbulesa 6, 4. Që kishte ndenjtur mbi të iu dha të ngrerë paqen nga dheu.

-Pashkë.

-Marku 14, 1. Edhe pas dy ditësh ishte pashka dhe të pabrumëtat.

-Lluka 2, 41. Në Jerusalem për të kremten e pashkës.

-Joani 2, 13. Edhe pashka e Judenjve ishte afër, dhe Jisui u ngjiti në Jerusalem.

-Joani 6, 4. Edhe ishte afër pashka, e kremtja e Judenjve.

-Joani 13, 1. Edhe përpara të kremtes së pashkës Jisui.

-1 Korintasve 5, 7. Sepse pashka jonë, që është Krishti, u bë theror për ne.

-Hebrenjve 11, 28. Me anë të besimit bëri pashkën dhe spërkatjen e gjakut.

Pavël.

-Veprat e Apostujve 13, 9. Po Sauli, që quhej edhe Pavël, u mbush me Shpirt të Shenjtë.

-1 Korintasve 1, 12. Unë jam i Pavlit, dhe: Unë i Apolloit.

-Galatasve 1, 1. Pavli, apostull jo prej njerëzish, as me anë njeriu.

-Titit 1, 1. Pavli, shërbëtor i Perëndisë, dhe apostull i Jisu Krishtit.

-2 Pjetrit 3, 15. Vëllai ynë i dashur Pavël ju shkroi juve sipas ditorisë.

Pendim.

-Matheu 3, 8. Bëni pra pemë të vlefshme për pendim.

-Matheu 3, 11. Unë ju pagëzoj me ujë për pendim.

-Lluka 24, 47. Të predikohej në emrin e tij pendim dhe ndjesë mëkatesh.

-Veprat e Apostujve 26, 20. Të pendohen dhe të kthehen tek Perëndia, duke bërë punë të denja për pendim.

-Romakëve 2, 4. Se mirësia e Perëndisë të sjell ty në pendim?

-2 Korintasve 7, 10. Sepse hidhërimi sipas udhës së Perëndisë sjell pendim për shpëtim.

-2 Timotheut 2, 25. Kështu mbase u jep atyre Perëndia pendim, që të njohin të vërtetën.

-2 Pjetrit 3, 9. Nuk do që të humbasin disa veta, por të gjithë të vijnë në pendim.

Perëndi.

-Lluka 20, 25. Jepini pra Qezarit ato që janë të Qezarit,

dhe Perëndisë ato që janë të Perëndisë.

-Romakëve 2, 11. Sepse tek Perëndia s'ka mbajtje ane.

-Romakëve 13, 6. Janë shërbëtorë Perëndie, që kujdesen për këtë.

-1 Korintasve 8, 5. Sepse ndonëse ka asish që thuhën perëndira.

-1 Korintasve 14, 33. Perëndia nuk është Perëndi ngatërrimi, po paqeje.

-2 Korintasve 1, 3. I bekuar qoftë Perëndia dhe Ati i Zotit tonë Jisu Krisht.

-2 Korintasve 4, 4. Perëndia i kësaj jete ua verboi mendimet atyre që s'besojnë.

-Hebrenjve 12, 29. Sepse "Perëndia ynë është zjarr që tret".

-1 Joanit 4, 8. Sepse Perëndia është dashuri.

Pilat.

-Matheu 27, 2. Edhe si e lidhën, e çuan dhe e dhanë në duart e Pont Pilatit.

-Matheu 27, 22. Pilati u thotë atyre: Ç'ta bëj pra Jisuin që quhet Krisht?

-Marku 15, 15. Edhe Pilati, pasi donte t'i bënte qejfin turmës, u lëshoi Barabain.

-Lluka 23, 12. Edhe atë ditë Pilati e Irodu u bënë miq njëri me tjetrin.

-Lluka 23, 13. Edhe Pilati si thirri bashkë kryepriiftërinjtë e të parët dhe popullin.

-Joani 18, 37. Pilati pra i tha: Mbret je ti, pra?

-Joani 19, 6. Pilati u thotë atyre: Merreni ju atë, dhe kryqëzoheni;

-Joani 19, 12. Që atëherë Pilati kërkonte ta lëshonte.

-Joani 19, 22. Pilati u përgjigj: Atë që e shkrova e shkrova.

-1 Timotheut 6, 13. Që dëshmoi në ditët e Pont Pilatit rrëfimin e mirë:

Punë.

-Veprat e Apostujve 19, 25. Ky si i mblodhi këta dhe ata që punonin.

-Romakëve 12, 11. Në punë të jeni të papërtueshëm, në shpirt të nxehtë.

-1 Korintasve 16, 14. Gjithë punët tuaja le të bëhen me dashuri.

-1 Selanikasve 5, 13. Me dashuri fort tepër për punën e tyre.

Q

Qaj.

-Matheu 8, 12. Atje do të jetë të qarët dhe kërcëllitja e dhëmbëve.

-Matheu 13, 50. Atje do të jetë të qarët dhe kërcëllitja e dhëmbëve.

-Lluka 6, 22. Lum ju që qani tani, sepse do të qeshni.

-Lluka 23, 28. Bija të Jerusalemit, mos qani për mua, po qani për veten tuaj.

-Zbulesa 18, 15. Për frikën e mundimit të saj, duke qarë e duke vajtuar.

Qengj.

-Lluka 10, 3. Shkoni; ja unë tek po ju dërgoj ju si shqerra në mes të ujqërve.

-Joani 1, 29. Ja Qengji i Perëndisë, që ngre mëkatën e botës.

-Joani 21, 15. Kullot shqerrat e mia.

-Zbulesa 5, 6. Një Qengj që prrinte si i therur.

-Zbulesa 7, 10. Që ka ndenjur mbi fron dhe i Qengjit.

Qielli.

-Matheu 11, 11. Por më i vogli në mbretërinë e qiejve është më i madh se ai.

-Matheu 24, 35. Qielli edhe dheu do të shkojnë, po fjalët e mia nuk do të shkojnë.

-Lluka 17, 24. Vetëtima që vetëtin prej njëres anë nën qiell, ndrit deri në anën tjetër nën qiell.

-Joani 3, 13. Asnjë s'ka hipur në qiell, veç ai që ka zbritur nga qielli, i Biri i njeriut, që është në qiell.

-Veprat e Apostujve 2, 34. Sepse Davidi nuk u ngjit në qiejt;

-2 Pjetrit 3, 5. Se me fjalën e Perëndisë u bënë qiejt që në lashtësi.

-2 Pjetrit 3, 10. Ditë në të cilën qiejt do të shkojnë me krismë.

-2 Pjetrit 3, 13. Edhe sipas premtimit të atij presim qiej të rinj dhe tokë të re.

-Zbulesa 12, 7. Edhe u bë luftë në qiell.

-Zbulesa 19, 11. Edhe pashë qiellin të hapur.

Qytet.

-Lluka 4, 43. Po ai u tha atyre, se edhe nëpër qytetet e tjera.

-Lluka 19, 17. Ki pushtet përmbi dhjetë qytete.

-Matheu 5, 14. Një qytet që është mbi mal nuk mund të fshihet.

-Hebrenjve 11, 10. Sepse priste qytetin që kishte themelet.

-Hebrenjve 11, 16. Sepse bëri gati për ata një qytet.

-Zbulesa 16, 19. Edhe qyteti i madh u nda në tri pjesë, dhe qytetet e kombeve ranë.

-Zbulesa 21, 2. Qytetin e shenjtë, Jerusalemin e ri.

R

Rabi.

-Matheu 23, 8. Po ju mos u quani Rabi, sepse një është mësuesi juaj, Krishti.

-Joani 1, 39. Edhe ata i thanë: Rabi, - që e përkthyer do me thënë, Mësues.

-Joani 3, 2. Rabi, e dimë se nga Perëndia ke ardhur mësues.

Rahaba.

-Hebrenjve 11, 31. Me anë të besimit Rahaba e përdalë nuk humbi bashkë me ata që s'bindeshin.

-Jakovit 2, 25. Rahaba e përdalë a nuk doli e drejtë nga veprat.

Rakela.

-Matheu 2, 18. Rakela qante djemtë e saj, dhe nuk donte të ngushëllohej.

Robëri.

-Lluka 21, 24. Edhe do të bien prej goje thikash, dhe do të skllavërohen nëpër gjithë kombet.

-2 Korintasve 10, 5. Dhe robërojmë çdo mendim që t'i bindet Krishtit.

Romak.

-Veprat e Apostujve 16, 37. Ne që jemi njerëz Romakë e na vunë në burg.

-Veprat e Apostujve 23, 27. Sepse mora vesh se është romak.

-Veprat e Apostujve 25, 16. Nuk është zakon ndër Romakët të jepet ndonjë njeri në vdekje.

-Veprat e Apostujve 28, 17. Më dhanë nga Jerusalemi të lidhur në duart e romakëve.

-Joani 11, 48. Do të vijnë Romakët, dhe do të prishin edhe vendin tonë edhe kombin.

Rutha.

-Matheu 1, 5. Edhe Salmonit i lindi Vozi nga Rahaba; dhe Vozit i lindi Ovidi nga Ruthi.

RR

Rremë.

-Matheu 24, 24. Sepse do të ngrihen krishtër të rremë dhe profetë të rremë.

-Matheu 26, 59. Edhe kryepriiftërinjtë e pleqtë dhe gjithë kuvendi kërkonin dëshmi të rreme kundër Jisuit.

-2 Korintasve 11, 13. Sepse njerëz të tillë janë apostuj të rremë, punëtorë mashtrues.

-Galatasve 2, 4. Për shkak të vëllezërve të rremë që ishin futur fshehurazi.

-1 Timotheut 6, 20. O Timothe, ruaj atë që të është besuar, duke u larguar nga fjalët e kota të ndyra.

Rrethprerje.

-Romakëve 2, 29. Por Judeas është ai që është përbrenda Judeas, dhe rrethprerje ajo e zemrës.

-Romakëve 4, 11. Edhe mori shenjën e rrethprerjes për vulë të drejtësisë që fitoi prej besimit që kishte kur ishte i parrethprerë.

-1 Korintasve 7, 19. Rrethprerja s'është gjë, edhe parrethprerja s'është gjë, po ruajtja e porosive të Perëndisë.

-Kolosianëve 2, 11. Në të cilin edhe u rrethpretë me rrethprerje që s'bëhet me dorë, duke zhveshur trupin e mëkateve të mishit me anë të rrethprerjes së Krishtit.

Rrobë.

-Matheu 9, 16. Askush nuk vë arnë pëlhere të re mbi rrobë të vjetër, sepse mbushja e saj heq nga rroba, dhe grisja bëhet më e keqe.

-Matheu 10, 5. Në udhë kombesh mos shkoni, dhe në qytet Samaritanësh mos hyni.

-Matheu 13, 4. Edhe ndërsa ai po mbillte, disa fara ranë pranë udhës.

-Matheu 20, 17. Edhe Jisui, duke u ngjitur në Jerusalem, mori me vete të dymbëdhjetë nxënësit mënjane në udhë.

-Matheu 23, 5. Zgjerohet hajmalitë e tyre dhe zmadhohet cepat e rrobave të tyre.

-Matheu 27, 35. Edhe si e kryqëzuan, ndanë rrobat e tij duke hedhur short, që të plotësohet ç'është thënë nga profeti: "Ndanë rrobat e mia në mes tyre, dhe për veshjen time hodhën short".

-Zbulesa, 16, 15. Lum ai që rri zgjuar dhe ruan rrobat e tij, që të mos ecë zhveshur e të shohin shëmtitë e tij.

Rrugë.

-Matheu 3, 3. Bëni gati udhën e Zotit; bëni rrugët e tij të drejta.

-Matheu 7, 14. Sepse e ngushtë është dera dhe e shtrënguar është udha që çon në jetë.

-Matheu 22, 9. Shkoni pra nëpër daljet e udhëve, dhe sa të gjeni, t'i ftoni në dasmë.

-Marku 11, 8. Edhe shumë veta shtruan rrobat e tyre në rrugë; dhe të tjerë këputnin degë prej pemëve e i shtronin në rrugë.

-Veprat e Apostujve 8, 26. Ngrihu e shko nga jugu, në rrugën që zbret prej Jerusalemit në Gazë.

-Hebrenjve 3, 10. Përherë gënjehen në zemrën e tyre; dhe ata nuk i njohën udhët e mia.

Rrush.

-Matheu 7, 16. A mos mbledhin rrush nga drizat, apo fiq nga murrizat?

-Zbulesa 14, 18. Dërgo draprin tënd të mprehtë dhe vil rrushin e vreshtit të dheut, sepse u poq rrushi i tij.

S

Sabat.

-Matheu 12, 8. Sepse i Biri i njeriut është i zoti edhe i së shtunës.

-Matheu 24, 20. Edhe faluni që të mos bëhet ikja juaj në dimër, as të shtunën.

-Marku 2, 27. E shtuna është bërë për njeriun, e jo njeriu për të shtunën.

-Lluka 14, 5. Kujt prej jush, po t'i bjerë gomari a kau në pus, dhe nuk e nxjerr menjëherë ditën e shtunë?

-Kolosianëve 2, 16. Le të mos ju gjykojë pra, askush për ngrënie a për pirje, ose për gjëra që kanë të bëjnë me festa a me hënë të re, ose me të shtuna.

-Hebrenjve 4, 9. Mbetet pra, prehje për popullin e Perëndisë.

Saduce.

-Matheu 3, 7. Edhe kur pa se shumë nga Farisenjtë e Saduqenjtë po vinin në pagëzimin e tij.

-Matheu 22, 23. Në atë ditë i erdhën pranë Saduqenj, të cilët thonë se nuk ka ngjallje; dhe e pyetën.

-Veprat e Apostujve 23, 6. Dhe Pavli, si e kuptoi se njëra pjesë ishte prej Saduqenjsh, dhe tjetra prej Farisenjsh, bërtiti në kuvend.

-Veprat e Apostuujve 23, 7. Edhe si foli ai këtë, u bë një grindje në mes të Farisenjve e të Saduqenjve, dhe shumica u nda më dysh.

-Veprat e Apostujve 23, 8. Sepse Saduqenjtë thonë se s'ka ngjallje, as engjëll, as shpirt; kurse Farisenjtë i pohojnë që të dyja.

Safira.

-Veprat e Apostujve 5, 1. Po një burrë që e kishte emrin

Anania, bashkë me gruan e tij, Safirën, shiti një pronë.

Saloma.

-Marku 15, 40. Maria Magdalena, dhe Maria, e ëma e Jakovit të vogël dhe e Josiut, dhe Saloma.

-Marku 16, 1. Maria Magdalena, dhe Maria, e ëma e Jakovit, dhe Saloma, blenë erëra, që të vijnë e ta lyejnë.

Samaritan.

-Matheu 10, 5. Në udhë kombesh mos shkoni, dhe në qytet Samaritanësh mos hyni.

-Lluka 10, 33. Po një Samaritan, duke udhëtuar, erdhi në vendin ku ishte ai, dhe kur e pa, iu dhimbs.

-Lluka 17, 16. Ra përmbys në këmbët e tij, dhe e falënderoi; dhe ai ishte Samaritan.

-Joani 4, 9. I thotë pra atij gruaja Samaritane: Si ti, duke qenë Judeas, kërkon të pish prej meje, që jam një grua

Samaritane? - Sepse Judenjtë nuk shoqërohen me Samaritanët.

-Veprat e Apostujve 8, 25. Dhanë lajmin e mirë nëpër shumë katunde të Samaritanëve.

Sandale.

-Marku 6, 9. Por të jenë mbathur me sandale dhe të mos veshin dy rroba.

-Joani 1, 27. Ai është ai që vjen pas meje, i cili është më i madh se unë, të cilit unë s'jam i zoti t' i zgjidh lidhëzën e këpucës.

Sapokthyer (i, e).

-1 Timothuet 3, 6. Të mos jetë i sapokthyer në besim, që të mos fryhet me madhështi e të bjerë në dënim të djallit.

Sara.

-Romakëve 9, 9. Sepse fjala e premtimit është kjo: "Në këtë kohë do të vij, dhe Sara do të ketë bir".

-Hebrenjve 11, 11. Me anë të besimit edhe ajo, Sarra, mori fuqi të bëhet shtatzënë, dhe, ndonëse i kishte shkuar koha e moshës, lindi.

-1 Pjetrit 3, 6. Siç i bindej Sara Abrahamit, duke e quajtur atë zot.

Satana.

-Matheu 4, 10. Atëherë Jisui i thotë atij: Ik prej meje, Satana.

-Matheu 12, 26. Edhe Satanai në nxjerrtë Satanain, u nda kundër vetes së tij; si pra do të qëndrojë mbretëria e tij?

-Matheu 16, 23. Ik prej meje, Satana, se më je skandal; sepse s'ke ndër mend punët e Perëndisë, po punët e njerëzve.

-Marku 1, 13. Edhe ishte atje në shkretëtirë dyzet ditë dhe ngitej nga Satanai.

-Marku 4, 15. Përnjëherë vjen Satanai dhe merr fjalën që është mbjellë në zemrat e tyre.

-Lluka 10, 18. Edhe ai u tha atyre: Vështroja Satanain duke rënë nga qielli si vetëtimë.

-Lluka 22, 3. Edhe Satanai hyri te Juda që quhej Iskariot, i cili ishte nga numri i të dymbëdhjetëve.

-Veprat e Apostujve 26, 18. Nga pushteti i Satanait tek Perëndia, që të marrin ndjesë mëkatesh.

-Romakëve 16, 20. Edhe Perëndia i paqes do të dërrmojë satanain në këmbët tuaja për së shpejti.

-1 Korintasve 5, 5. T'ia dorëzoni të tillin Satanait për prishjen e trupit, që t'i shpëtojë shpirti në ditën e Zotit Jisu.

-2 Korintasve 2, 10. Që të mos teprojë fuqia e Satanait mbi ne.

-2 Korintasve 11, 14. Edhe s'është për t'u çuditur; sepse vetë Satanai ndërron formën në engjëll drite.

-2 Korintasve 12, 7. Edhe që të mos krenohem për zbulesat e shumta, m'u dha një gjemb në trup, engjëll satana.

-Zbulesa 2, 9. Thonë për veten e tyre se janë Judenj, dhe nuk janë, por janë mbledhje e satanait.

-Zbulesa 12, 9. Edhe u hodh poshtë dragoi i madh, gjarpri i vjetër që quhet djall, dhe satanai, ai që mashtron gjithë botën, u hodh poshtë në tokë.

-Zbulesa 20, 2. Edhe zuri dragoin, gjarpërin e vjetër, i cili është djalli dhe Satanai.

-Zbulesa 20, 7. Edhe kur të mbarojnë të një mijë vjetët, do të zgjidhet Satanai nga burgu i tij.

Sauli.

-Veprat e Apostujve 8, 3. Edhe Sauli i bënte keq kishës, duke hyrë nëpër shtëpitë, e duke hequr zvarrë burra e gra i hidhte në burg.

-Veprat e Apostujve 9, 1. Edhe Sauli, ende duke shfryrë kërcënime e vrasje kundër nxënësve të Zotit, erdhi te kryepriifti.

-Veprat e Apostujve 9, 4. Edhe ai si ra përdhe, dëgjoi një zë duke i thënë atij: Saul, Saul, pse më ndjek?

-Veprat e Apostujve 11, 25. Atëherë Varnava doli në Tars, për të kërkuar Saulin; dhe si e gjeti, e pruri në Antioki.

-Veprat e Apostujve 12, 25. Edhe Varnava e Sauli, pasi mbaruan shërbesën, u kthyen nga Jerusalemi.

-Veprat e Apostujve 13, 1. Manaini që ishte rritur bashkë me Irod tetrarkun, dhe Sauli.

-Veprat e Apostujve 13, 9. Po Sauli, që quhej edhe Pavël, u mbush me Shpirt të Shenjtë, e hodhi sytë mbi të.

-Veprat e Apostujve 22, 7. Dëgjova një zë që më thoshte: Saul, Saul, pse më ndjek?

-Veprat e Apostujve 26, 14.
Saul, Saul, pse më ndjek?

Sëpatë.

-Lluka 3, 9. Sëpata gjendet në rrënjët e drurëve.

Sila.

-Veprat e Apostujve 15, 22.
Zgjodhën Judën që përmbiquhej Barsaba, dhe Silën, njerëz të parë ndër vëllezërit.

-Veprat e Apostujve 16, 19.
Zunë Pavlin dhe Silën e i sollën në treg tek të parët.

-Veprat e Apostujve 17, 4. U bashkuan me Pavlin e me Silën, si dhe një shumicë e madhe nga Grekët.

-Veprat e Apostujve 18, 5.
Edhe kur zbritën nga Maqedonia Sila e Timotheu, Pavli vuante në shpirt e jepte dëshmi tek Judenjtë se Jisui është Krishti.

Siloam.

-Lluka 13, 4. Apo ata të tetëmbëdhjetët, mbi të cilët ra pirgu në Siloam.

-Joani 9, 7. Shko e lahu në pellgun e Siloamit.

-Joani 9, 11. Shko në pellgun e Siloamit dhe lahu.

Simon.

-Matheu 4, 18. Pa dy vëllezër, Simonin, që thirrej edhe Pjetër, dhe Andrean, vëllanë e tij.

-Matheu 10, 2. Edhe emrat e të dymbëdhjetë Apostujve janë këto: i pari, Simoni, që thuhet Pjetër, dhe Andrea, vëllai i tij.

-Marku 3, 16. Simonin, të cilit ia vuri emrin Pjetër.

Sinagogë.

-Matheu 23, 6. Edhe duan kreun e mësallës nëpër darkat dhe vendet e para nëpër sinagoga.

-Joani 18, 20. Unë përherë mësova njerëzit në sinagogë dhe në tempull.

-Veprat e Apostujve 17, 17. Fliste pra në sinagogë me Judenjtë.

-Veprat e Apostujve 18, 26. Edhe ky zuri të flasë me guxim në sinagogë.

-Zbulesa 3, 9. Ja tek do t'i bëj ata të sinagogës së satanait.

Sinedër.

-Matheu 26, 59. Kryepriiftërinjtë e pleqtë dhe gjithë sinedri kërkonin dëshmi të rreme kundër Jisuit, që ta vrisnin atë, po nuk gjetën.

-Lluka 22, 66. E prunë lart në sinedrin e tyre duke thënë: Nëse je ti Krishti, na thuaj.

-Veprat e Apostujve 5, 21. Thirrën sinedrin dhe gjithë pleqësinë e bijve të Izraelit.

Sion.

-Matheu 21, 5. “Thuajini bijës Sionë: Ja mbreti yt tek po të vjen i butë dhe hipur mbi gomare dhe mbi pulisht bir shtaze”.

-Romakëve 9, 33. Ja tek vë në Sion një gur pengese.

-Romakëve 11, 26. Do të vijë prej Sionit ai që shpërblen.

-Hebrenjve 12, 22. Por u afruat në malin Sion, dhe në qytetin e Perëndisë së gjallë.

Solomon.

-Matheu 6, 29. Po ju them juve se as Solomoni me gjithë lavdinë e tij nuk qe veshur ashtu si një nga këto.

-Matheu 12, 42. Që të dëgjojë diturinë e Solomonit; dhe ja këtu tek është më tepër se Solomoni.

-Veprat e Apostujve 7, 47. Edhe Solomoni i ndërtoi atij shtëpi.

Stefan.

-Veprat e Apostujve 6, 5. Zgjodhën Stefanin, që ishte burrë plot me besim e me Shpirt të Shenjtë.

-Veprat e Apostujve 7, 59. Edhe qëllonin Stefanin me gurë tek lutej e thoshte: O Zoti Jisu, prano shpirtin tim.

-Veprat e Apostujve 8, 2. Edhe disa burra besimtarë e ngritën Stefanin, dhe bënë vajtim të madh mbi të.

-Veprat e Apostujve 22, 20. Edhe kur derdhej gjaku i Stefanit, dëshmitarit tend.

Sy.

-Matheu 14, 19. Ngriti sytë përpjetë në qiejt dhe bekoi; dhe pasi i theu, ua dha bukët nxënësve, dhe nxënësit turmave.

-1 Korintasve 2, 9. Ato që sy s'i pa, e vesh s'i dëgjoi.

-1 Korintasve 15, 52. Sa hap e mbyll sytë, në trumbetën e fundit.

-Efesianëve 1, 18. Që sytë e mendjes suaj të jenë të ndriçuar.

SH

Shandan.

-Hebrenjve 9, 2. Sepse u ndërtua tenda e parë, në të cilën ishte edhe kandilmbajtësja, edhe tryeza, edhe paravënia e bukëve, tendë e cila quhet Shenjtërore.

-Zbulesa 1, 12. Edhe u ktheva të shoh zërin që foli me mua; dhe kur u ktheva, pashë shtatë kandila të artë.

-Zbulesa 1, 13. Edhe në mes të shtatë kandilave një që ngjante me bir njeriu.

-Zbulesa 1, 20. Të shtatë yjet janë engjëjt e të shtatë kishave; dhe të shtatë kandilat janë të shtatë kishat.

-Zbulesa 2, 1. Këto thotë ai që mban të shtatë yjet në të djathtën e tij, ai që ecën në mes të shtatë kandilave të artë.

Shenjtë.

-Veprat e Apostujve 26, 10. Gjë të cilën edhe e bëra në Jerusalem dhe shumë nga shenjtorët unë i mbylla në burgje.

-Romakëve 12, 13. Në nevojat e shenjtorëve të ndihmoni; nga mikpritja mos hiqni dorë.

-1 Korintasve 6, 2. A nuk e dini se shenjtorët do të gjykojnë botën?

-Efesianëve 3, 8. Mua më të voglit nga të gjithë shenjtorët m'u dha ky hir.

-Efesianëve 4, 12. Për formimin e shenjtorëve, për veprën e shërbesës.

-Zbulesa 11, 18. T'u japësh pagën shërbëtorëve të tu profetë, dhe shenjtorëve.

-Zbulesa 17, 6. Edhe pashë gruan duke u dehur nga gjaku i shenjtorëve.

Shembëlltyrë.

-Matheu 22, 20. Edhe ata i prunë një dinar. Edhe ai u thotë atyre: E kujt është kjo fytyrë dhe ky mbishkrim?

-1 Korintasve 15, 49. Edhe siç veshëm figurën e të baltit, do të veshim edhe figurën e qiellorit.

-Zbulesa 14, 9. Kush t'i falet bishës dhe shembëlltyrës së saj.

-Zbulesa 20, 4. Të cilët nuk iu falën bishës, as shembëlltyrës së saj.

Shëroj.

-Matheu 8, 7. Edhe Jisui i thotë atij: Unë do të vij e do ta shëroj.

-Matheu 9, 35. Duke shëruar çdo sëmundje e çdo lëngatë në popull.

-Matheu 12, 15. Shkuan pas tij shumë turma, dhe i shëroi ata të gjithë.

-Matheu 13, 15. Kuptojnë me zemrën, edhe kthehen, e i shëron ata.

-Marku 3, 2. Edhe vinin re atë nëse do ta shëronte të shtunën, që ta akuzonin.

-Lluka 4, 23. Mjek, shëro veten tënde.

-Lluka 6, 7. Nëse do të shërojë të shtunën, që të gjenin shkak akuze kundër tij.

-Lluka 9, 11. Ata që kishin nevojë shërimi i shëronte.

-Lluka 10, 9. Shëroni të sëmuret që gjenden në të, dhe u thoni atyre.

-Lluka 13, 14. Jisui ditën e shtunë e shëroi, dhe i thoshte turmës.

-Veprat e Apostujve 10, 38. I cili shkoi vend më vend duke bërë mirë e duke shëruar gjithë ata që mundoheshin prej djallit.

Shkel.

-Matheu 5, 19. Ai pra që të shkelë qoftë edhe një nga këto porositë e vogla.

-Matheu 15, 3. Përse edhe ju shkelni porosinë e Perëndisë për hir të traditës suaj?

-Lluka 21, 24. Jerusalemi do të shkelet prej kombesh, deri sa të plotësohen kohët e kombeve.

-Romakëve 2, 25. Po nëse shkel ligjin, rrethprerja jote u bë parrethprerje.

-Hebrenjve 10, 29. Sa mundim më të keq ju duket juve se do të heqë ai që ka shkelur me këmbë të Birin e Perëndisë.

-Zbulesa 11, 2. Qytetin e shenjtë do ta shkelin dyzet e dy muaj.

Shkëmb.

-Matheu 16, 18. Edhe unë po të them se ti je Pjetër (shkëmb), dhe përmbi këtë

shkëmb do të ndërtoj kishën time.

-Lluka 8, 6. Edhe tjetër ra mbi shkëmb, dhe sapo mbiu u tha, sepse nuk kishte lagështirë.

-Romakëve 9, 33. Një shkëmb skandali, dhe kushdo që beson tek ai nuk do të turpërohet.

-1 Korintasve 10, 4. Edhe të gjithë po atë pije shpirtërore pinë; sepse pinin nga guri shpirtëror që u vinte pas; edhe ky gur ishte Krishti.

-1 Pjetrit 2, 7. Për ju pra që besoni është i çmuar; po për të pabindurit “guri që hodhën tej ndërtuesit, ky u bë kreu i qoshes dhe gur pengese e gur skandali”.

Shkrim.

-Matheu 21, 42. Jisui u thotë atyre: Kurrë s’keni lexuar në shkronjat.

-Matheu 22, 29. Edhe Jisui u përgjigj e u tha atyre: Jeni të

gënjyer, se nuk dini shkronjat, as fuqinë e Perëndisë.

-Lluka 4, 21. Edhe zuri t'u thoshte atyre se sot u përmbush ky shkrim në veshët tuaj.

-Lluka 24, 27. U komentonte atyre ato që ishin shkruar për të nëpër gjithë shkrimet.

-Lluka 24, 32. A nuk digjej zemra jonë ndër ne, kur na fliste udhës dhe na zgjidhte shkrimet?

-Lluka 24, 45. Atëherë u hapi mendjen atyre, që të merrnin vesh shkrimet.

-Joani 5, 47. Por në qoftë se nuk u besoni shkrimeve të tij, si do t'u besoni fjalëve të mia?

-Joani 5, 39. Vëzhgoni shkronjat, sepse ju kujtoni se në ato keni jetë të përjetshme; dhe ato janë ato që dëshmojnë për mua.

-Joani 10, 35. Në qoftë se quajti perëndira ata, tek të cilët

u bë fjala e Perëndisë, dhe shkrimi s'mund të bjerë poshtë.

-Joani 13, 18. Nuk i them këto për ju të gjithë; unë di cilët kam zgjedhur; po që të plotësohet shkrimi.

-Joani 20, 9. Sepse ende s'kuptonin shkrimin, se ai duhet të ngjallet prej së vdekurish.

-Veprat e Apostujve 8, 32. Edhe vendi i shkrimit që po lexonte ishte.

-Veprat e Apostujve 17, 2. Edhe Pavli sipas zakonisht të tij hyri tek ata, dhe tri të shtuna me radhë diskutonte me ta pjesë prej shkrimeve.

-Veprat e Apostujve 17, 11. Por këta ishin më të fisëm se ata të Thesalonikut, sepse e pranuan fjalën me gjithë zemër, duke vëzhguar përditë shkrimet.

-Veprat e Apostujve 18, 24. Edhe një Judeas që quhej

Apollo, lindur në Aleksandri, i cili ishte njeri i zoti në fjalë dhe i fortë në shkrimet, zbriti në Efes.

-Romakëve 15, 4. Sepse sa u parashkruan, u parashkruan për mësimin tonë, që të kemi shpresë me anë të durimit e të ngushëllimit të shkrimeve.

-2 Timotheut 3, 15. Edhe se që nga foshnjëria i di shkronjat e shenjta.

-2 Timotheut 3, 16. Gjithë shkrimi është prej Shpirtit të Perëndisë, dhe i dobishëm për mësim, për qortim, për ndreqje, për arsim që është me drejtësi.

-2 Pjetrit 1, 20. Se asnjë profeci e shkrimit nuk shpjegohet nga pikëpamja vetjake e atij që komenton.

-2 Pjetrit 3, 16. Sikurse edhe shkrimet e tjera, për humbjen e vetes së tyre.

Short.

-Joani 19, 24. Ndanë rrobat e mia në mes tyre, dhe shtinë short mbi pelerinën time.

-Veprat e Apostujve 1, 26. Edhe u dhanë atyre shorte; dhe shorti i ra Matisë.

-Veprat e Apostujve 13, 19. Edhe pasi prishi shtatë kombe në dhe të Kanaanit, u ndau atyre me short dheun e tyre.

Shpellë.

-Matheu 21, 13. “Shtëpia ime do të quhet shtëpi lutjeje”; por ju e bëtë atë “shpellë kusarësh”.

Shpëtim.

-Lluka 1, 69. Edhe ngriti bri shpëtimi mbi ne në shtëpinë e Davidit.

-Lluka 1, 77. Për t’i dhënë mend shpëtimi popullit të tij, me anë të ndjesës së mëkateve.

-Lluka 2, 30. Sepse sytë e mi panë shpëtimin tend.

-Lluka 3, 6. Edhe çdo mish do të shohë shpëtimin e Izraelit.

-Joani 4, 22. Sepse shpëtimi është nga Judenjët.

-Romakëve 10, 10. Sepse njeriu beson me zemër për drejtësi, dhe me gojë rrëfëhet për shpëtim.

-Romakëve 13, 11. Sepse tani shpëtimi ynë është më afër sesa kur besuam.

-2 Korintasve 6, 2. Ja tani tek është kohë e pëlqyeshme; ja tani tek është ditë shpëtimi.

-2 Korintasve 7, 10. Sepse hidhërimi sipas udhës së Perëndisë sjell pendim për shpëtim.

-Efesianëve 6, 17. Edhe merrni përkrenaren e shpëtimit, dhe thikën e Shpirtit, që është fjala e Perëndisë.

-Filipianëve 2, 12. Punoni për shpëtimin e vetes suaj me frikë e me dridhje.

2 Timotheut 3, 15. Të cilat mund të të bëjnë të ditur për shpëtim me anë të besimit.

-Hebrenjve 2, 3. Në mos u kujdesshim për një shpëtim kaq të madh.

-Hebrenjve 2, 10. Të bëjë me anë të pësimeve të përsosur kryetarin e shpëtimit të tyre.

-Hebrenjve 5, 9. Edhe si u bë i përsosur, u bë shkak për shpëtim të përjetshëm.

Zbulesa 7, 10. Shpëtimi është i Perëndisë tonë që ka ndenjur mbi fron dhe i Qengjit.

-Zbulesa 12, 10. Tani u bë shpëtimi dhe fuqia dhe mbretëria e Perëndisë tonë.

Shpëtimtar.

-Lluka 2, 11. Sepse sot ju lindi juve në qytetin e Davidit një shpëtimtar, i cili është Zoti Krisht.

-Veprat e Apostujve 5, 31. E bëri të parë dhe shpëtimtar, që

t'i japë pendim Izraelit dhe ndjesë mëkatesh.

-Veprat e Apostujve 13, 23. Prej farës së këtij Perëndia sipas premtimit të tij, i ngriti Izraelit shpëtimtar Jisuin.

-1 Timotheut 4, 10. I cili është shpëtimtari i gjithë njerëzve, po më fort i besimtarëve.

-2 Timotheut 1, 10. Që u shfaq tani me anë të dukjes së shpëtimtarit tonë Jisu Krisht.

-1 Joanit 4, 14. Edhe ne e kemi parë dhe dëshmojmë se Ati dërgoi Birin Shpëtimtar të botës.

Shpëtojt.

-Matheu 10, 22. Edhe do t'ju kenë mëri të gjithë për emrin tim.

-Matheu 16, 25. Sepse ai që të dojë të shpëtojë shpirtin e tij, do ta humbasë atë.

-Matheu 19, 25. Vallë, cili mund të shpëtojë?

-Matheu 24, 22. Edhe po të mos shkurttoheshin ato ditë, nuk do të shpëtonte asnjë trup.

-Lluka 19, 10. Sepse Biri i njeriut erdhi të kërkojë e të shpëtojë të humburën.

-Lluka 21, 36. Rrini zgjuar pra duke u lutur në çdo kohë, që të bëheni të zotët të shpëtoni.

-Joani 3, 17. Sepse Perëndia nuk e dërgoi të Birin në botë që të gjykojë botën, po që të shpëtojë bota me anë të tij.

-Veprat e Apostujve 4, 12. Edhe nuk ka shpëtim me anë të asnjë tjetri; sepse asnjë tjetër emër nën qiell s'është dhënë në mes njerëzve, me anë të të cilit duhet të shpëtojmë.

-Veprat e Apostujve 23, 27. Unë arrita bashkë me ushtrinë dhe e shpëtova.

-Romakëve 10, 9. Se Perëndia e ngjalli atë prej së vdekurish, do të shpëtosh.

-Romakëve 10, 13. Sepse kushdo që të thërrisë emrin e Zotit, do të shpëtojë.

-1 Korintasve 1, 18. Sepse fjala e kryqit për ata që humbasin është marrëzi, po për ne që shpëtojmë është fuqi Perëndie.

Shpresë.

-Veprat e Apostujve 26, 7. Për këtë shpresë akuzohem, o mbret Agripa, prej Judenjve.

-Romakëve 5, 5. Edhe shpresa nuk turpëron, sepse dashuria e Perëndisë është derdhur në zemrat tona.

-Romakëve 8, 21. Me shpresë se edhe vetë krijesa do të çlirohet nga robëria e prishjes.

-Romakëve 8, 24. Sepse me shpresën shpëtuam; por shpresa që shihet nuk është shpresë, sepse për atë gjë që sheh njeriu, përse edhe të shpresojë?

-Romakëve 15, 4. Që të kemi shpresë me anë të durimit e të ngushëllimit të shkrimeve.

-Efesianëve 2, 12. Pa pasur shpresë, dhe të paperëndi në botë.

-1 Selanikasve 4, 13. Që të mos ju vijë keq, si edhe të tjerëve që s'kanë shpresë.

-Hebrenjve 6, 19. Të kemi ngushëllim të fortë ne që u sulëm që të mbajmë shpresën që kemi përpara.

-Hebrenjve 10, 23. Le të mbajmë të patundur rrëfimin e shpresës.

-1 Pjetrit 3, 15. Cilindo që të kërkojë prej jush fjalë për shpresën që është ndër ju.

Shtëpi.

-Matheu 10, 36. Edhe armiqtë e njeriut do të jenë pjesëtarët e shtëpisë së tij.

-Matheu 21, 13. Eshtë shkruar “Shtëpia ime do të quhet

shtëpi lutjeje”; por ju e bëtë atë
“shpellë kusarësh”.

-Matheu 23, 38. Ja shtëpia juaj
tek po ju lihet e shkretë.

-Marku 3, 25. Edhe një shtëpi
në u ndaftë kundër vetes së saj,
ajo shtëpi s’ mund të qëndrojë.

-Marku 10, 30. Që të mos
marrë për një njëqind tani në
këtë kohë, shtëpi, e vëllezër, e
motra, e nënë, e bij, e ara.

-Veprat e Apostujve 7, 49.
Çfarë shtëpie do të ndërtoni
për mua? thotë Zoti.

-Veprat e Apostujve 20, 20. Po
jua tregova e jua mësova juve
botërisht e nëpër shtëpitë.

-Romakëve 16, 5. Si edhe
kishën që është në shtëpinë e
tyre.

-Hebrenjve 3, 3. Sa ka më
shumë nder se shtëpia ai që e
ndërtoi atë.

-Hebrenjve 3, 6. Si bir mbi
shtëpinë e tij, shtëpia e të cilit
jemi ne.

1 Pjetrit 2, 5. Ndërtohuni në
shtëpi shpirtërore, priftëri të
shenjtë.

T

Tade.

-Matheu 10, 3. Jakovi i Alfeut dhe Leveu që u quajt me përmbiemrin Tade.

-Marku 3, 18. Jakovin, të birin e Alfeut, e Tadeun, e Simon Kananeasin.

Taksambledhës.

-Matheu 5, 46. A nuk e bëjnë këtë edhe taksambledhësit?

-Matheu 18, 17. Atëherë le të jetë ai si pagani e taksambledhësi.

-Matheu 21, 31. Me të vërtetë po ju them juve, se taksambledhësit dhe të përdalat.

-Matheu 21, 32. Po taksambledhësit e të përdalat i besuan.

-Marku 2, 15. Ishin ulur në tryezë edhe shumë taksambledhës e mëkatarë

bashkë me Jisuin e me nxënësit e tij.

-Marku 2, 16. Kur e panë atë duke ngrënë bashkë me taksambledhës e me mëkatarë.

-Lluka 3, 12. Erdhën edhe taksambledhës që të pagëzoheshin.

-Lluka 7, 29. Edhe gjithë populli që dëgjuan atë dhe taksambledhësit.

-Lluka 15, 1. Edhe gjithë taksambledhësit e mëkatarët i afroheshin, që ta dëgjonin.

-Lluka 18, 10. Njëri ishte farise dhe tjetri taksambledhës.

-Lluka 18, 11. Ose edhe si ky taksambledhës.

Tamara.

-Matheu 1, 13. Edhe Judës i lindi Faresi dhe Zarai nga Tamara.

Tempull.

-Joani 2, 15. I nxori të gjithë nga tempulli, edhe dhentë edhe

qetë; dhe derdhi paret e sarafëve, dhe tryezat i përmbysi.

-Joani 2, 19. Prisheni këtë tempull dhe për tri ditë do ta ngre.

-Veprat e Apostujve 17, 24. Duke qenë Zot i qiellit e i dheut, nuk rri në tempuj.

-1 Korintasve 3, 16. Nuk e dini se jeni tempull Perëndie, dhe Shpirti i Shenjtë rri tek ju?

-2 Korintasve 6, 16. Sepse ju jeni tempulli i Perëndisë së gjallë.

-Efesianëve 2, 21. E gjithë ndërtesa e lidhur bashkë rritet në tempull të shenjtë në Zotin.

-2 Selanikasve 2, 4. Kaq sa të rrijë në tempull të Perëndisë si Perëndi.

-Zbulesa 3, 12. Fitimtarin, atë do ta bëj shtyllë në tempullin e Perëndisë tim.

-Zbulesa 7, 15. Prandaj janë përpara fronit të Perëndisë,

dhe e adhurojnë ditë e natë në tempullin e tij.

-Zbulesa 11, 19. Edhe u hap tempulli i Perëndisë në qiell, dhe u duk arka e dhiatës së atij në tempullin e tij.

Timothe.

-Veprat e Apostujve 16, 1. Ishte atje një nxënës që quhej Timothe, i biri i një gruaje Judease besimtare, dhe i një ati Grek.

-1 Korintasve 4, 17. Prandaj ju dërgova Timotheun, i cili është biri im i dashur.

-1 Timotheut 1, 2. Timotheut, djalit të thjeshtë në besim, i goftë hir, përdëllim, paqe.

Titi.

-2 Korintasve 2, 12. Nuk pata qetësi në shpirtin tim, sepse nuk gjeta Titin, vëllanë tim.

-2 Korintasve 12, 18. Iu luta Titit, dhe bashkë me të dërgova vëllanë.

-Galatasve 2, 1. U ngjita në Jerusalem bashkë me Varnavën, si mora me vete edhe Titin.

-Titit 1, 4. Titit, birit të thjeshtë sipas besimit tonë të përbashkët, i qoftë hir, përdëllim, paqe.

Tundim.

-Matheu 6, 13. Dhe mos na shtjer në ngasje, po shpëtona nga i ligu.

-Matheu 26, 41. Rrini zgjuar dhe faluni, që të mos hyni në ngasje.

-Lluka 4, 13. Edhe djalli pasi mbaroi çdo ngasje, u largua prej tij deri në një kohë.

-1 Korintasve 7, 5. Mblidhuni bashkë që të mos ju ngasë Satanai.

-1 Korintasve 10, 13. Tjetër ngasje nuk ju ka ndodhur juve, përveçse ngasje njerëzore.

-1 Timotheut 6, 9. Dhe ata që duan të bëhen të pasur, bien në ngasje dhe në lak.

TH

Thesar.

-Matheu 6, 20. Po mblidhni thesarë për veten tuaj në qiell, ku nuk i prish as krimb as ndryshk.

-Matheu 6, 21. Sepse ku është thesari juaj, atje do të jetë edhe zemra juaj.

-Matheu 12, 35. Njeriu i mirë nxjerr të mirat nga thesari i mirë i zemrës; dhe njeriu i lig nxjerr të liga nga thesari i lig.

-Matheu 13, 44. Përsëri, mbretëria e qiejve ngjan me një thesar të fshehur në arë.

-Matheu 19, 21. Në do të bëhesh i përsosur, shko e shit pasurinë tënde, dhe jepua të varfërve; dhe do të kesh thesar në qiell.

-Marku 12, 43. Kjo e ve e varfër hodhi më tepër se të gjithë ata që hodhën në arkën e thesarit.

-Lluka 21, 1. Edhe hodhi sytë e pa të pasurit që hidhnin dhuratat e tyre në thesar.

-Joani 8, 20. Këto fjalë i foli Jisui në vendin e thesarit, duke mësuar njerëzit në tempull.

-2 Korintasve 4, 7. Edhe kemi këtë thesar në enë balte, që të jetë teprimi i fuqisë nga Perëndia dhe jo nga ne.

Thirrje.

-Romakëve 11, 29. Sepse dhuratat dhe thirrja e Perëndisë janë të patundshme.

-Efesianëve 4, 1. U lutem pra juve unë i burgosuri në Zotin, të ecni denjesisht në thirrjen që u thirrët.

-Filipianëve 3, 14. Për çmimin e thirrjes prej së larti të Perëndisë në Jisu Krishtin.

-2 Timotheut 1, 9. I cili na shpëtoi dhe na thirri me thirrje të shenjtë.

-Hebrenjve 3, 1. Prandaj, vëllezër shenjtorë, pjesëtarë të thirrjes qiellore.

-2 Pjetrit 1, 10. Prandaj, vëllezër, kujdesuni më tepër të siguronit thirrjen dhe zgjedhjen tuaj.

-2 Selanikasve 1, 11. Prandaj edhe ne falemi përherë për ju, që t'ju bëjë Perëndia ynë të denjë për thirrjen e tij.

Thoma.

-Matheu 10, 3. Filipi dhe Vartholomeu; Thomai dhe Mathe tagrambledhësi.

-Joani 20, 24. Po Thomai, një nga të dymbëdhjetët, që quhet Binjak.

-Veprat e Apostujve 1, 13. Pjetri dhe Jakovi dhe Joani e Andrea, Filipi dhe Thomai.

U

Udhë.

-Joani 14, 6. Unë jam udha dhe e vërteta dhe jeta.

-Veprat e Apostujve 9, 2. Që nëse gjen disa prej kësaj udhe, burra e gra, t'i sjellë lidhur në Jerusalem.

-Veprat e Apostujve 19, 9. Po pasi disa nga ata ashpërsoheshin e s'u mbushej mendja dhe flisnin keq për udhën e Zotit përpara turmës.

-Veprat e Apostujve 22, 4. Edhe këtë udhë e ndoqa deri në vdekje.

-Veprat e Apostujve 24, 14. Por pohoj këtë tek ti, se sipas udhës.

-Romakëve 11, 33. Sa të pahetueshme janë gjykimet e tua, dhe sa të pakuptueshme udhët e tua!

-Zbulesa 15, 3. Të drejta dhe të vërteta janë udhët e tua, o mbret i shenjtoreëve.

Ujë.

-Matheu 10, 42. Dhe ai që t'i japë vetëm një kupë ujë të ftohtë.

-Joani 4, 14. Por ai që pi nga uji që do t'i jap unë, nuk do të ketë etje për gjithë jetën.

-Joani 7, 38. Ai që më beson mua, siç tha Shkrimi, lumenj uji të gjallë do të rrjedhin nga barku i tij.

-Zbulesa 7, 17. Qengji që është në mes të fronit do t'i ruajë ata e do t'i udhëheqë ata në burime ujërash të gjalla.

-Zbulesa 22, 17. Dhe ai që do, le të marrë falas ujin e jetës.

Ulli.

-Romakëve 11, 17. Po nëse u këputën ca nga degët, dhe ti që ishe ulli i egër u shartove.

-Romakëve 11, 24. Sepse nëse u këpute ti nga ulliri i egër prej natyre.

-Zbulesa 11, 4. Këta janë të dy drurët e ullirit.

Ungjillor.

-Veprat e Apostujve 21, 8. Edhe të nesërmen, ne që ishim bashkë me Pavlin, dolëm e erdhëm në Qesari dhe si hymë në shtëpinë e Filip Ungjillorit.

-Efesianëve 4, 11. Edhe ai dha që disa të jenë apostuj, e disa profetë, e disa ungjillorë.

-2 Timotheut 4, 5. Po ti rri zgjuar në të gjitha, vuaj, bëj punë ungjillori, shërbesën tënde mbaroje.

Urdhër.

-Matheu 15, 3. Përse edhe ju shkelni urdhërin e Perëndisë për hir të traditës suaj?

-Matheu 15, 9. Edhe kot më nderojnë, duke mësuar

mësime që janë urdhëra njerëzish.

-Matheu 22, 40. Gjithë ligji dhe profetët varen nga këto dy urdhëra.

-Marku 12, 28. Cila porosi është e para e të gjithave?

-Joani 12, 50. Edhe e di se porosia e tij është jeta e përjetshme.

-Joani 14, 21. Ai që ka porositë e mia dhe i ruan, ky është ai që më do.

Uri.

-Matheu 5, 6. Lum ata që kanë uri e etje për drejtësinë, sepse ata do të ngopen.

-Joani 6, 35. Unë jam buka e jetës. Ai që vjen tek unë, nuk do të ketë uri.

-Zbulesa 7, 16. Nuk do të kenë uri, as nuk do të kenë më etje.

Urrej.

-Matheu 5, 43. Të duash të afërmin tënd, dhe t'i kesh mëri armikut tënd.

-Matheu 6, 24. Asnjë s'mund t'u shërbejë dy zotërinjve, sepse ose njërit do t'i ketë mëri, dhe tjetrin do ta dojë.

-Matheu 24, 9. Atëherë do t'ju dorëzojnë juve për shtrëngim dhe do t'ju vrasin; dhe do t'ju kenë mëri gjithë kombet për emrin tim.

-Lluka 6, 22. Të lumtur jeni ju, kur t'ju kenë smirë njerëzit, dhe kur t'ju veçojnë, dhe t'ju shajnë.

-Lluka 6, 27. Duajini armiqtë tuaj; bëjuni mirë atyre që ju kanë smirë.

-Joani 3, 20. Sepse kushdo që bën të këqija, i ka mëri dritës, dhe nuk vjen tek drita.

-Joani 7, 7. Bota s'mund t'ju ketë mëri ju; por mua më ka mëri, sepse unë dëshmoj për të se punët e saj janë të liga.

-Joani 12, 25. Ai që do jetën e tij do ta humbasë; po ai që urren jetën e tij në këtë botë, do ta ruajë për jetë të përjetshme.

-Joani 15, 19. Por unë ju zgjodha ju nga bota, prandaj ju ka mëri bota.

-Joani 17, 14. Unë u dhashë atyre fjalën tënde; dhe bota i urrejti, sepse nuk janë nga bota, siç nuk jam unë nga bota.

-Romakëve 7, 15. Sepse atë që bëj nuk e njoh; sepse nuk bëj atë që dua, po bëj atë që kam smirë.

-Romakëve 9, 13. Jakovin e desha, po Isafin e pata smirë.

-Herbrenjve 1, 9. Deshe drejtësinë dhe pate smirë paudhësinë.

-1 Joanit 3, 15. Kushdo që urren të vëllanë, është njerivrasës.

-1 Joanit 4, 20. Në thëntë ndonjë se dua Perëndinë, dhe urren vëllanë e tij, është gënjeshtar.

V

Vaj.

-Matheu 25, 4. Po të mençurat morën vaj në enët e tyre bashkë me llambat e tyre.

-Lluka 7, 46. Ti me vaj nuk më leve kryet; po ajo me vaj erërash më leu këmbët.

-Hebrenjve 1, 9. Prandaj të leu, o Perëndi, Perëndia yt, me vaj gëzimi më tepër se pjesëtarët e tu.

Vajtoj.

-Matheu 5, 4. Lum ata që vajtojnë, sepse ata do të ngushëllohen.

-Lluka 6, 25. Mjerë ju që qeshni tani, se do të mbani zi e do të qani.

-Joani 16, 20. Me të vërtetë, me të vërtetë po ju them juve, se ju do të qani e do të ulërin.

Varr.

-Matheu 23, 27. Mjerë ju shkrues e Farisenj, hipokritë, sepse ngjani me varre të lyer me gëlqere.

-Matheu 23, 29. Mjerë ju shkrues e Farisenj, hipokritë, sepse ndërtoni varret e profetëve dhe stolisni përmendoret e të drejtëve.

-Matheu 27, 52. Edhe varret u hapën, dhe shumë trupa shenjtorësh që kishin vdekur u ngjallën.

-Matheu 27, 61. Edhe atje ishte Maria Magdalena, dhe Maria tjetër, duke ndenjur përballë varrit.

-Marku 6, 29. Edhe nxënësit e tij, kur dëgjuan, erdhën dhe ngritën trupin e tij, dhe e vunë në varr.

-Joani 5, 28. Të gjithë ata që janë nëpër varret do të dëgjojnë zërin e tij.

-Joani 11, 17. Kur erdhi pra Jisui, e gjeti se kishte tashmë katër ditë në varr.

Vdekje.

-Matheu 25, 46. Edhe këta do të shkojnë në mundim të përjetshëm; dhe të drejtët në jetë të përjetshme.

-Romakëve 5, 12. Me anë të mëkatit vdekja, dhe kështu shkoi vdekja mbi të gjithë njerëzit, sepse që të gjithë mëkatuan.

-Romakëve 5, 17. Sepse në qoftë se prej fajit të njërit mbretëroi vdekja me anë të njërit.

-Romakëve 6, 23. Sepse paga e mëkatit është vdekje.

-1 Korintasve 15, 21. Sepse sikurse vdekja erdhi me anë njeriu, kështu edhe ngjallja e të vdekurve është me anë njeriu.

-1 Korintasve 15, 26. Armiku i fundit që do të asgjësohet është vdekja.

-Hebrenjve 2, 9. Por Jisuin që qe bërë pakgjë më i ulët nga engjëjt e shohim, prej pësimit të vdekjes.

-Hebrenjve 2, 14. Që të prishë me anë të vdekjes atë që ka pushtetin e vdekjes, domethënë djallin.

-Zbulesa 2, 10. Bëhu besnik deri në vdekje, dhe do të të jap kurorën e jetës.

Vegim.

-Veprat e Apostujve 11, 5. Unë isha duke u falur në qytetin e Jopës; dhe pashë një pamje në vegim.

-Veprat e Apostujve 16, 9. Edhe Pavlit iu duk natën një fanitje se një njeri Maqedonas.

Veprat e Apostujve 22, 17. Edhe pasi u ktheva në

Jerusalem, tek isha duke u falur në tempull, erdha në vegim.

Vejushë.

-Lluka 20, 47. Të cilët hanë shtëpitë e të vejave, duke nxjerrë shkak se falen shumë.

-Lluka 21, 3. Me të vërtetë po ju them juve, se kjo e ve e varfër.

-1 Timotheut 5, 3. Të vejat nderoi, ato që janë me të vërtetë të veja.

-Jakovit 1, 27. Të shikojë njeriu jetimë e të veja në shtrëngim të tyre.

-Zbulesa 18, 7. Nuk jam e ve, dhe s'kam për të parë vaj.

Verbër.

-Matheu 15, 14. Lërimi ata, se janë të verbër që u heqin udhën të verbërve.

-Matheu 23, 24. Udhëheqës të verbër, që shtrydhni

mushkonjën, dhe gamilen e përpini.

-Joani 12, 40. Verboi sytë e tyre, dhe ashpërsoi zemrën e tyre, që të mos shohin me sytë.

-2 Korintasve 4, 4. Perëndia i kësaj jete ua verboi mendimet atyre që s'besojnë.

-1 Joanit 2, 11. Po ai që i ka mëri të vëllait, në errësirë ecën, dhe nuk di se ku shkon, sepse errësira i verboi sytë.

Verë.

-Matheu 9, 17. Edhe as nuk vënë verë të re në kacekë të vjetër.

-Matheu 24, 32. Kur bëhet tashmë dega e tij e butë dhe nxjerr gjethet, e dini se vera është afër.

-Joani 2, 9. Edhe i pari i tryezës, si u provua uji që ishte bërë verë.

-1 Timotheut 3, 8. Dhiakonët gjithashtu, duhet të jenë të sjellshëm, jo me dy faqe, jo të dhënë pas verës së shumtë.

-Efesianëve 5, 18. Edhe mos u dehni me verë, në të cilën ka plangprishje.

-1 Timotheut 5, 23. Mos pi më ujë, po përdor pakëz verë për stomakun tend.

-Zbulesa 18, 3. Sepse nga vera e zemërimit të imoralitetit të saj pinë gjithë kombet.

Vëlla.

-Matheu 5, 22. Por unë po ju them juve se kushdo që zemërohet më kot kundër vëllait të tij, do të jetë fajtor në gjyq; dhe ai që t'i thotë të vëllait: "Rraka", do të jetë fajtor në kuvend.

-Matheu 12, 49. Ja nëna ime dhe vëllezërit e mi.

-Matheu 12, 50. Sepse kush të bëjë dëshirën e Atit tim që është në qiejt, ai më është vëlla dhe motër dhe nënë.

-Matheu 18, 15. Edhe në të bëftë faj yt vëlla, shko dhe qortoje në mes teje dhe të atij vetëm; në të dëgjoftë, e fitove vëllanë tënd.

-Matheu 23, 8. Po ju mos u quani Rabi, sepse një është mësuesi juaj, Krishti, dhe të gjithë ju jeni vëllezër.

-Matheu 25, 40. Me të vërtetë po ju them juve, gjithë sa i bëtë njërit prej këtyre vëllezërve të mi më të vegjël, ma keni bërë mua.

-Marku 13, 12. Edhe vëllai do të dorëzojë të vëllanë për vdekje, dhe i ati të birin.

-Veprat e Apostujve 15, 36. Le të kthehemi tani të shohim si janë vëllezërit tanë në çdo qytet.

-Hebrenjve 2, 11. Shkak për të cilin nuk turpërohet t'i quajë ata vëllezër,

-Zbulesa 12, 10. Sepse u hodh poshtë akuzuesi i vëllezërve tanë.

Virgjëreshë.

-Matheu 25, 1. Atëherë mbretëria e qiejve do të ngjajë me dhjetë virgjëresha.

-1 Korintasve 7, 25. Edhe për virgjëreshat s'kam porosi nga Zoti.

-1 Korintasve 7, 36. Po nëse kujton ndonjëri se sillet shëmtuar me virgjëreshën e tij.

-2 Korintasve 11, 2. Që t'ju nxjerr përpara Krishtit si virgjëreshë të pastër.

Vullnet.

-Matheu 6, 10. Ardhtë mbretëria jote, u bëftë dëshira jote, si në qiell, ashtu edhe mbi dhe.

-Lluka 22, 42. O Atë, nëse do, largoje këtë potir prej meje; veç jo dëshira ime, po jotja le të bëhet.

-Joani 5, 30. Siç dëgjoj, gjykoj; dhe gjyqi im është i drejtë; sepse s'kërkoj dëshirën time, po dëshirën e Atit që më dërgoi.

-Romakëve 9, 19. Cili mund të rrijë kundër vullnetit të tij?

-Hebrenjve 10, 10. Prej kësaj dëshire jemi shenjtëruar me anë të flijimit të trupit të Jisu Krishtit që u bë theror një herë për të gjithë.

XH

Xhelozi.

-1 Korintasve 3, 3. Sepse deri sa ka ndër ju smirë dhe grindje e ndarje.

-1 Korintasve 13, 4. Dashuria është zemërgjerë dhe bën të mira; dashuria nuk ka smirë; dashuria nuk mburret, nuk fryhet.

2-Korintasve 11, 2. Sepse ju kam zili me zili Perëndie.

Y

Ylber.

-Zbulesa 4, 3. Edhe ai që rrinte ngjante në pamje me gur diaspri dhe sardi; dhe ishte një ylber rreth fronit.

-Zbulesa 10, 1. Edhe pashë një tjetër engjëll të fuqishëm duke zbritur nga qielli, të veshur me re; dhe kishte ylber mbi krye.

Yll.

-1 Korintasve 15, 41. Tjetër është lavdia e diellit, dhe tjetër lavdia e hënës, dhe tjetër lavdia e yjeve; sepse ylli nga ylli dallon në lavdi.

-Zbulesa 2, 28. Edhe do t'i jap atij yllin e mëngjesit.

-Zbulesa 12, 1. Mbi kryet e asaj ishte një kurorë me dymbëdhjetë yje.

Z

Zakeu.

-Lluka 19, 2. Edhe ja një njeri i quajtur me emrin Zake, i cili ishte kryetagrambledhës; dhe ishte i pasur.

-Lluka 19, 5. Zake, zbrit shpejt; sepse sot unë do të qëndroj në shtëpinë tënde.

-Lluka 19, 8. Edhe Zakeu qëndroi e i tha Zotit: Ja, o Zot, gjysmën e pasurisë sime tek po ua jap të varfërve.

Zebedeu.

-Matheu 4, 21. Edhe si shkoi më tej, pa dy vëllezër të tjerë, Jakovin, të birin e Zebedeut.

-Lluka 5, 10. Gjithashtu edhe Jakovin e Joanin, të bijtë e Zebedeut.

-Joani 21, 2. Nathanaili që është nga Kana e Galilesë, dhe të bijtë e Zebedeut.

ZH

Zhgënjim.

-Romakëve 10, 11. Sepse shkrimi thotë: “Gjithkush që beson në atë, nuk do të zhgënjehet”.

-1 Pjetrit 2, 6. Ai që e beson atë nuk do të zhgënjehet.

Zhvendos.

-1 Korintasve 13, 2. Po të kem gjithë besimin sa të lëviz nga vendi male.

Zhyt.

-1 Timotheut 6, 9. Dhe ata që duan të bëhen të pasur, bien në ngasje dhe në lak.

BIBLIOGRAFI

- Azem Qazimi, *Fjalor i Krishterimit*, Plejad, 2010.
- Bibla, Diodati i Ri*, përkthimi 1991-94, La buona Novella, Brindizi.
- Dhiata e Re e zotit edhe Shpëtimtarit t'ënë Jisu Krisht, kthyerë prej Elinishtesë Shqip ndë të folë toskërisht prej Kostandin Kristoforidhit*, botim i KOASH-it, Tiranë 1994.
- Dhjata e Re, Psalmet, Fjalët e Urta*, botimet Lajmi i Mirë, Tiranë.
- Erasmus Schmid, *Concordance to the Greek New Testament*, Astir, Athens 1990.
- Fjalor i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 2006.
- Fjalor Greqisht-Shqip i Dhiatës së Re*, përgatitur për botim nga Joan Lena, Shoqëria Biblike, Tiranë 2007.
- Fran Luli, *Fjalor Biblik dhe i termave kishtarë*, Camaj-Pipa, Shkodër 2004.
- Holy Bible*, Good News Edition, The Bible Societies, New York 1982.
- Nestle-Aland, *Novum Testament Graece*, Deutsche Bibelgesellschaft, Stuttgart 1993.
- Strongs Exhaustive Concordance of the Bible*, World Bible Publishers.
- The Exhanstive James Strong Concordance of the Bible*, World Bible Publishers.
- Ungjilli sipas Mateut, sipas Markut, sipas Lukës, sipas Gjonit, Veprat e Apostujve, Libri i Psalmeve, Libri i Fjalëve të Urta*, përktheu dhe shtjelloi Dom Simon Filipaj, Shoqëria biblike Ndërkonfesionale e Shqipërisë, Tiranë 1999.
- Xavier Leon-Dufor, *Fjalor i Teologjisë Biblike*, Chrico, Napoli 2009.

**CIP Katalogimi në botim
BK Tiranë**

Llukani, Andrea

Redaktor: Dr. Moikom Zeqo

Concordance e Testamentit

të Ri,

Andrea Llukani, Tiranë:

Botimet “Trifon Xhagjika”,

2011

118 f, 20 cm.

ISBN